

## K R E U III

# **PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË NË LUFTË PËR RINDËRTIMIN E VENDIT DHE PËR ZHVILLIMIN E REVOLUCIONIT SOCIALIST**

**(Dhjetor 1944-1948)**

### 1. MBROJTJA DHE FORCIMI I PUSHTETIT POPULLOR

Pushteti popullor, që u vendos gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, menjëherë pas luftës filloi të kryente funksionet e diktaturës së proletariatit. Nën udhëheqjen e pandarë të Partisë Komuniste, ky pushtet siguronte ruajtjen e fitoreve të revolucionit antiimperialist demokratik dhe zhvillimin e tij të pandërprerë e të menjëhershëm në revolucion socialist. Vendit i çelej kështu perspektiva e sigurt e zhdukjes së shpejtë të plagëve të luftës e të prapambetjes së trashëguar nga e kaluara, e zhvillimit të vrullshëm të ekonomisë e të kulturës popullore, e çlirimit të masave punonjëse nga varfëria e nga shfrytëzimi.

Për kryerjen e detyrave të mëdha që dilnin pas Çlirimit, Partisë i duhej medoemos të mbante parasysh gjendjen e brendshme dhe ndërkombëtare.

**Ndryshimi rrënjësor i raportit  
të forcave në botë në dobi  
të socializmit**

Kur Shqipëria u çlirua nga pushtuesit e huaj, Lufta e Dytë Botërore vazhdonte ende. Ajo

përfundoi me kapitullimin pa kushte të Gjermanisë hitleriane më 9 maj 1945 dhe të Japonisë militariste më 2 shtator 1945.

Fytyra e botës pësoi ndryshime të mëdha.

Bashkimi Sovjetik socialist pati humbje në njerëz dhe materiale më shumë se çdo vend tjetër. Por prej luftës ai doli politikisht dhe ushtarakisht më i fortë. Autoriteti dhe prestigji ndërkombëtar i tij u rritën shumë.

Në një numër vendesh në Evropë e në Azi, si pasojë e fitores së revolucionit, lindën regjime të reja popullore demokratike.

Shkëputja e këtyre vendeve nga sistemi botëror kapitalist shënonte një ndryshim rrënjësor në raportin e forcave në dobi të socializmit në shkallë ndërkombëtare.

Në këto kushte mori një hov të madh lëvizja nacionalçlirimtare dhe antikoloniale. Procesi i shthurjes së sistemit kolonial përfshiu hapësira të mëdha. Në Azi dhe në Afrikë u krijuan një varg shtetesh të reja kombëtare.

Këto ndryshime të mëdha e thelluan shumë krizën e përgjithshme të kapitalizmit, krijuan kështu kushte më të përshatshme për fitoren e socializmit në shkallë botërore.

Ndryshime, të cilat sollën prishjen e ekuilibrit brenda sistemit botëror të kapitalizmit, ndodhën edhe në raportin e forcave në mes fuqive imperialiste. Gjermania, Japonia dhe Italia, që u mundën në Luftën e Dytë Botërore, humbën pozitën politike dhe ushtarake të mëparshme. Ekonomia e tyre ishte shkatërruar. Por të dobësuar shumë ekonomikisht, ushtarakisht e politikisht ndodheshin edhe Britania e Madhe me Francën. Ato s'luanin më rolin e dikurshëm si fuqi të mëdha.

Vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën nga lufta më të forta. Ato e rritën pa masë fuqinë e tyre ekonomike e ushtarake dhe u bënë tani qendra kryesore e botës kapitaliste.

Fuqitë imperialiste nuk mund të pajtoheshin me rritjen e forcave socialiste e demokratike në botë dhe me vrullin që mori lëvizja çlirimtare antikoloniale. Të prira nga imperializmi amerikan, i cili vuri në lëvizje makinën e tij gjigante burokratik-shtetërore, potencialin e tij të madh ekonomik-financiar dhe ushtarak, këto fuqi mobilizuan të gjitha forcat e mjetet, ngritën më këmbë tërë reaksionin botëror në luftë të ashpër kundër Bashkimit Sovjetik socialist dhe vendeve të demokracisë popullore, kundër gjithë forcave revolucionare, demokratike dhe antiimperialiste.

Karakteristikë kryesore e gjendjes ndërkombëtare të pasluftës ishte krijimi i dy kampeve: kampi demokratik antiimperialist

rialist dhe kampi imperialist antidemokratik, që kishin qëllime strategjike diametralisht të kundërta.

Kampi demokratik antiimperialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, kishte si qëllim mbrojtjen e socializmit, të demokracisë, të lirisë e të pavarësisë kombëtare në të gjitha ato vende ku këto qenë siguruar, përkrahjen e lëvizjeve revolucionare e nacionalçlirimtare që synonin asgjësimin e sundimit borgjez e imperialist, ruajtjen e paqes në botë. Kjo do të arrihej në luftë të papajtueshme me imperializmin dhe reaksionin ndërkombëtar, me gjithë shërbëtorët e tyre, duke bashkuar në këtë luftë proletariatin botëror, forcat demokratike e përparimtare, popujt liridashës.

Kampi imperialist antidemokratik drejtohej nga SHBA. Ai kishte si qëllim të shpëtonte e të ruante rendin e vjetër kapitalist, të rimëkëmbte kapitalizmin evropianoperëndimor e japonez, të shtypte çdo lëvizje revolucionare e nacionalçlirimtare, të rivendoste kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik e në vendet e demokracisë popullore. Vetë imperializmi amerikan synonte të vendoste hegjemoninë e tij kudo në botë.

I udhëhequr nga ky qëllim, imperializmi ndërkombëtar me SHBA në krye organizonte njërën pas tjetrës fushata të tërbuara armiqësore kundër kampit demokratik antiimperialist e kundër partive komuniste në vendet kapitaliste. Ai ndërhyri drejtpërdrejt me armë dhe mbyti me gjak lëvizjen kryengritëse demokratike në Greqi. Njëkohësisht goditi rëndë lëvizjet revolucionare demokratike në Francë, në Itali e gjetkë. SHBA filluan zbatimin e një politike të hapët agresive, militariste, përgatitjet për një luftë të re botërore. Shprehje e kësaj politike e të këtyre përgatitjeve, që përfshinë të gjitha drejtimet kryesore, politike, ekonomike, ushtarake, ishin «doktrina Truman» e «Plani Marshall». Në territorin e shumë vendeve të huaja, në Evropë, në Azi e gjetkë, krijuan baza ushtarake, përdorën në mënyrë të veçantë si mjet presioni e frikësimit monopolin e përkohshëm të bombës atomike. Politika agresive imperialiste e reaksionare u shoqërua me agresionin ideologjik antikomunist dhe me një veprimtari të gjerë subversive, për të minuar nga brenda Bashkimin Sovjetik, vendet e demokracisë popullore, partitë komuniste e punëtorë, për degjenerimin e tyre borgjez.

Presione të fuqishme armiqësore zhvillonin imperialistët edhe mbi Shqipërinë e re Demokratike Popullore.

## **Vështirësitë në gjendjen e brendshme**

Çlirimi e gjeti vendin në gjendje të vajtueshme. Ekonomia ishte tronditur nga themelet.

Energjia elektrike mungonte, minierat qenë bërë të papërdorshme. Ato pak fabrika që kishin shpëtuar pa u rrënuar gjithashtu nuk punonin, sepse mungonte lënda e parë. Të gjitha urat, të mëdha e të vogla, qenë hedhur në erë. Rrugët, portet, rrjeti telefonik ishin shkatërruar. Papunësia ishte përhapur kudo.

Edhe bujqësia ndodhej në gjendje shumë të rëndë. Një pjesë e tokës kishte mbetur e papunuar, 1/3 e bagëtisë, sidomos e kafshëve të punës, qe asgjësuar.

Tregtia ishte paralizuar nga skamja dhe nga mungesa e mjeteve të komunikacionit. Financat qenë boshatisur. Arin e bankës e kishin grabitur pushtuesit. Inflacioni kishte arritur përpjesëtime të padëgjjuara. Populli kishte nevojë të mëdha për veshmbathje, për strehë, për bukë. Rreziku i urisë dhe i sëmundjeve kanosej nga të katër anët.

Kjo gjendje rëndohej edhe më shumë nga lufta që bënin kundër pushtetit popullor forcat e reaksionit të brendshëm e të reaksionit të jashtëm imperialist, të lidhura në aleancë të ngushtë kundërrevolucionare.

Misionet amerikane dhe angleze, që qëndruan në Shqipëri edhe pas Çlirimit gjoja për të përgatitur njohjen e qeverisë së re, u kthyen në qendra spiunazhi, komplotesh e sabotimi.

Reaksioni i brendshëm, i mbështetur nga imperialistët amerikanë dhe anglezë, e përqendroi kryesisht veprimtarinë e vet në organizimin e kryengritjeve të armatosura kundërrevolucionare, duke përdorur bandat e kriminelëve të luftës të arratisur që ishin shpërndarë nëpër gjithë vendin, sidomos në krahinat e Veriut. Këto banda përpiqeshin të krijonin pasiguri, të frikësonin fshatarësinë dhe të pengonin vendosjen e rregullit e të qetësisë. Kryenin akte terroriste kundër komunistëve dhe aktivistëve të pushtetit popullor. Në janar 1945, mbeturina të forcave reaksionare kryen edhe një sulm të armatosur kundër Koplikut, por u shpartalluan brenda disa orësh.

Përfaqësues të borgjezisë reaksionare dhe të çifligarëve organizuan grupe të fshehta armiqësore, si grupi «monarkist», «socialdemokrat», «demokristian» etj., që drejtoheshin nga misioni anglez dhe amerikan në Tiranë. Këto grupe kryen dëmtime e sabotime në ekonomi.



Pas Çlirimit populli shqiptar priste me plot të drejtë vendosjen e marrëdhënieve të rregullta shtetërore me të gjithë aleatët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Por qeveritë e SHBA dhe të Anglisë pengonin me gjithfarë mënyrash vendosjen e marrëdhënieve të tilla. Qëllimi i tyre kryesor ishte të përmbysnin pushtetin popullor në Shqipëri.

Për këtë qëllim imperialistët amerikanë dhe anglezë kishin në plan të ndërmerrnin edhe një ndërhyrje të armatosur. Në janar 1945 kërkuan të zgjeronin misionet e tyre ushtarake në Tiranë dhe, në maj-qershor, të sillnin në Shqipëri 1500-1700 oficerë e teknikë të «Lidhjes Ushtarake» (M.L.) që do të merreshin gjoja me shpërndarjen e «ndihmave». Këto kërkesa u hodhën poshtë me vendosmëri nga Qeveria Demokratike e Shqipërisë.

Imperializmi përdori kundër Shqipërisë së re edhe Greqinë monarko-fashiste. E nxitur drejtpërdrejt nga SHBA dhe Anglia, fill pas Çlirimit, qeveria greke hapi një fushatë të gjerë me pretendimet e vjetra për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, organizoi provokacione sistematike kufitare dhe bëri përgatitje të gjithanshme për një agresion të armatosur, i cili do të shoqërohej me zbarkimin e forcave angleze nga deti.

Përballë rrezikut të ri që i kanosej vendit populli i shtrëngoi më shumë radhët rreth Partisë, për të mbrojtur me çdo kusht pavarësinë dhe tërësinë tokësore të atdheut, për të kryer njëkohësisht detyrat e zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit e të rindërtimit ekonomik.

Udhëheqja e popullit nga ana e Partisë në plotësimin e këtyre detyrave nuk ishte më pak e rëndësishme ose më pak e vështirë se udhëheqja e Luftës Nacionalçlirimtare. Por Partia kishte besim të plotë se do të kapërcente të gjitha vështirësitë e do t'ua dilte mbanë edhe detyrave të reja. Ky besim mbështetej në vendosmërinë e saj për ta çuar revolucionin deri në fund, në përvojën revolucionare të fituar gjatë luftës, në lidhjet e saj të ngushta me masat popullore e në entuziazmin e madh që i kishte përfshirë këto masa.

### **Ruajtja dhe forcimi i pushtetit popullor — problemi qendror**

Në këto rrethana hallka kryesore në zinxhirin e detyrave që qendronin para Partisë ishte ruajtja dhe forcimi i pushtetit popullor. «Pas çdo lufte e revolucionit, — udhëzonte KQ i PKSH, —

çështja më e rëndësishme dhe më e zorshme është marrja dhe mbajtja e pushtetit. Edhe për ne, për Partinë tonë, çështja më e rëndësishme është pushteti: ky paraqitet si problemi ynë qendror. Prandaj objektivi ynë kryesor sot është... ta forcojmë atë dhe me atë të kalojmë nga fitorja në fitore, nga reforma në reformë»<sup>1</sup>.

Për arritjen e këtij objektivi një rëndësi të veçantë kishte forcimi i bazës politike të pushtetit, i këshillave nacionalçlirimtarë, që ato të kryenin plotësisht rolin si «motor i çdo hapi përpara në fushën politike, ekonomike e shoqërore». Këtij qëllimi i shërbyen zgjedhjet e organeve lokale të pushtetit në gjithë vendin që u bënë në maj 1945.

Gjatë fushatës për zgjedhjet Partia zhvilloi një punë të gjerë politike me masat për t'ua bërë atyre më të qartë karakterin popullor të pushtetit të ri dhe detyrat e tij. Ajo demaskoi propagandën e reaksionit për «paaftësinë e pushtetit» dhe synimet e tij për ta kaluar drejtimin e këshillave në duart e përfaqësuesve «me përvojë» të klasave të përmbysura.

Në këshillat u zgjodhën njerëz të sprovuar në luftë, të vendosur, besnikë ndaj interesave të popullit dhe që gëzonin besimin e tij.

Krahas kësaj, Partia organizoi ndërtimin e plotë të aparatit shtetëror të ri, si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja. U ngritën mbi baza të reja institucione administrative, gjykatat popullore, u krijua Policia Popullore, u riorganizuan dhe u forcuan organet e Sigurimit të Shtetit etj.

Në aparatën e ri shtetëror Partia dërgoi nga kuadrot e saj më të mirë. Ishte e vërtetë se këtyre u mungonte përvoja e qeverisjes, por ata ishin të vendosur të zbatonin besnikërisht vijën e Partisë. Artin e qeverisjes do ta mësonin në punë e sipër.

Njëkohësisht në aparatën e ri shtetëror hynë edhe punonjës të administratës së vjetër, njerëz politikisht të lidhur me Partinë e me popullin, por me kulturë, me praktikë e me mentalitete borgjeze. Ata dhanë ndihmën e vet për funksionimin e aparatit të ri shtetëror. Por, krahas kësaj, në mënyrë të pandërgjegjshme futën në metodën e stilit të punës së aparatit të ri elemente të metodës e të stilit të aparatit të vjetër, disa forma

---

1 Qarkore e KQ të PKSH, dhjetor 1944, AQP.

burokratike të punës që nuk përputheshin me karakterin revolucionar të pushtetit.

Fuqia më e madhe e armatosur e revolucionit dhe e pushtetit ishte Ushtria Nacionalçlirimtare. Klasat e përmbysura dhe reaksioni i jashtëm shihnin në ushtrinë pengesën kryesore për t'ia arritur qëllimit të tyre kundër pushtetit popullor. Armiqtë synonin ta zhduknin atë duke kërkuar të çmobilizohesh, pasi Shqipërisë gjoja nuk i kanosej ndonjë rrezik e pasi ajo ishte një barrë e rëndë për shtetin dhe gjithë ekonominë e vendit!

Partia e çmonte mbajtjen dhe forcimin e ushtrisë si një çështje jetësore për revolucionin, për mbrojtjen e pushtetit popullor, të lirisë dhe të pavarësisë së vendit. Që ushtria të kryente misionin e saj të lartë, PKSHP kërkonte që ajo të përsosej, të modernizohesh dhe të bëhej «një ushtri model, një ushtri e pajisur me të gjitha cilësitë e vlefshme që të jetë e denjë... për të mbrojtur popullin dhe pushtetin e tij të ngritur me kaq sakrificë e gjak»<sup>1</sup>. Çdo sakrificë që bëhej nga ana e popullit dhe e shtetit për ushtrinë popullore ishte plotësisht e përligjur.

Në bazë të udhëzimeve të Komitetit Qendror, ushtria filloi përgatitjen luftarake sistematike për zotërimin e parimeve të luftës moderne. Për ngritjen e aftësive ushtarake e politike të komandantëve e komisarëve u hapën shkolla e kurse të rregullta. U vu në zbatim shërbimi ushtarak i detyrueshëm. Forcimin dhe modernizimin e ushtrisë Partia e shoqëroi me një punë politike të gjerë e të shumanshme për rritjen e ndërgjegjes revolucionare të luftëtarëve.

Nën udhëheqjen e Partisë ushtria u bë mburojë e sigurt e shtetit të ri demokratik popullor.

Një detyrë e ngutshme ishte spastrimi rrënjësor i vendit nga mbeturinat e forcave tradhtare. Partia e bëri zbatimin e kësaj detyre një aksion të madh politik, duke vënë në lëvizje gjithë popullin. Me përkrahjen e masave fshatare, organet e pushtetit dhe repartet ushtarake shfarosën bandat e armatosura kryesore të reaksionit. Gjykatat revolucionare të popullit u dhanë dënimin e merituar kriminelëve të luftës.

---

1 Enver Hoxha. Ushtria jonë Nacionalçlirimtare. Nëntor 1944. Vepra, vëll. 2, f. 416.

Proceset gjyqësore u shndërruan në një padi të madhe kombëtare kundër vijës së tradhtisë të ndjekur nga klasat shfrytëzuese. Ato ishin një grusht i rëndë jo vetëm për reaksionin e brendshëm, por edhe për përkrahësit e tij imperialistë.

## **Fronti Demokratik i Shqipërisë**

Detyrat e reja historike që qëndronin përpara Partisë mund të zgjidheshin vetëm në qoftë se do të ruhej e do të forcohej më tej bashkimi i masave të popullit rreth saj, i krijuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në kushtet e reja, në këtë bashkim duhej të përfshihejshin, përveç masave të gjera popullore që morën pjesë gjallërisht në luftën për çlirimin kombëtar, edhe të gjithë ata njerëz nga populli që kishin qëndruar mënjanë ose ishin mashtruar nga krerët reaksionarë.

Fronti Nacionalçlirimtar që kishte luajtur një rol vendimtar në fitoren mbi armiqtë e kishte përligjur plotësisht veten si një organizatë shumë e përshtatshme revolucionare për realizimin e bashkimit luftarak të masave të gjera. Përvoja e grumbulluar në këtë fushë do ta ndihmonte Partinë ta zhvillonte më tej traditën e bashkimit e të organizimit të drejtpërdrejtë të masave në Front nën udhëheqjen e saj.

Forcimi i mëtejshëm i Frontit ishte rruga më e përshtatshme demokratike që do të çonte edhe në shkatërrimin e orvatjeve të armiqtë të brendshëm e të jashtëm për të krijuar në Shqipëri parti «demokratike» reaksionare me qëllim që të përçanin popullin e t'i rrëmbenin atij fitoret e arritura.

Me parullën e bashkimit kombëtar **PKSH** organizoi Kongresin I të Frontit që u mbajt në gusht 1945. Në Kongres u përcaktuan detyrat e **Frontit Demokratik të Shqipërisë**, siç u quajt tani, dhe masat për forcimin e mëtejshëm të tij.

Fronti, si mishërim i unitetit të popullit rreth Partisë, ishte mbështetja kryesore e pushtetit popullor në luftën për ruajtjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare, për rindërtimin e vendit, për zhvillimin ekonomik-shoqëror e kulturor të tij në rrugën e socializmit.

Kongresi i Frontit, duke shprehur vullnetin e popullit, kërkoi të bëheshin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Pasi që themeluar shteti demokratik popullor në Kongresin e Përmetit, Asambleja do të sanksiononte, tani që gjithë vendi ishte çliruar, formën e regjimit politik e do të shpallte Kushtetu-

tën. Kjo detyrë që caktuar që në Mbledhjen II të KANÇ në tetor 1944.

Kongresi dhe zgjedhjet e këshillave të reja të Frontit e gjallëruan organizatën dhe e rritën rolin e saj në jetën e vendit.

Megjithatë, vija e Partisë në lidhje me Frontin u dëm-tua nga qëndrimi oportunist i Sejfulla Malëshovës dhe nga ndërhyrja e udhëheqjes së PKJ. Nën maskën e «luftës kundër sektarizmit» dyert e Frontit u hapën edhe për elementë ar-miq. Këtë e shfrytëzoi reaksioni për të futur me qëllim njerëzit e vet në Front, për ta minuar atë nga brenda dhe për të zhvi-lluar nga këto pozita luftën kundër pushtetit popullor. Por vigjilenca e Partisë dhe e masave të gjera të popullit u bë pengesë e pakapërcyeshme për veprimtarinë armiqësore të ele-mentëve të reaksionit brenda në Front.

Forca drejtuese në Front ishte **klasa punëtore**, përpara së cilës që çelur tani rruga e gjerë e rritjes dhe e shndërrimit në një klasë punëtore industriale me një ndërgjegje të lartë socialiste. Qysh në shkurt 1945 ajo kishte krijuar edhe orga-nizatat e veta profesionale (**sindikatat**). Bashkimet profesio-nale ngarkoheshin nga Partia të luanin një rol të rëndësishëm në edukimin komunist të punëtorëve e nëpunësve e të bëhe-shin «shtylla e fortë e Frontit Demokratik dhe e pushtetit popullor»<sup>1</sup>.

Si edhe më parë, baza më e gjerë e Frontit mbetej **fsha-tarësia punonjëse**, e cila kishte mbajtur peshën më të rëndë në Luftën Nacionalçlirimtare. Me vendosjen e pushtetit po-pullor qenë krijuar të gjitha mundësitë që ajo të përmbushte ëndrrat shekullore: të merrte tokën dhe të dilte nga mjerimi e prapambetja.

Si leva të fuqishme të Partisë për mobilizimin dhe edu-kimin politik të masave një rol të veçantë luanin Bash-kimi i Rinisë Antifashiste Shqiptare dhe Bashkimi i Grave An-tifashiste Shqiptare që vepronin në gjirin e Frontit Demokratik.

**Rinisë shqiptare**, si pjesa më e gjallë e më luftarake e po-pullit, i binte të ishte në krye të betejës së re për rindërtimin dhe ndërtimin socialist të vendit. Duke çmuar rolin e saj të

---

1 Udhëzime të KQ të PKSH mbi punën përgatitore për Kongre-sin I të sindikatave, 2 shtator 1945. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 326.

madh, shoku Enver Hoxha i drejtohej rinisë me këto fjalë në Kongresin II të saj: «Qeveria Demokratike, që ka vënë shpresën tek ju, është e bindur se ju do të jeni kurdoherë në pararojë, ju do të hidheni në punë ashtu si u hodhët në luftë, ju do të mësoni dhe do të edukoheni me një zell të madh për të mirën tuaj dhe të popullit, ju do të forconi dhe do të ndihmoni ushtrinë tonë, mburojën e çeliktë të interesave të popullit, ju do të mbroni pushtetin për të cilin dhatë kaq gjak...»<sup>1</sup>.

**Gruaja shqiptare** me pjesëmarrjen dhe kontributin e saj në luftë kishte treguar se ishte një faktor i domosdoshëm për zhvillimin e jetës politike e shoqërore të vendit. Hapi i parë i madh drejt çlirimit të saj, i kryer gjatë luftës, duhej të shërbente si bazë për çlirimin e plotë të të gjitha masave të grave, për t'u bërë ato një forcë e madhe në ndërtimin e shoqërisë së re. Partia kërkonte tani që të drejtat e barabarta të gruas me burrin, të ligjësuara nga Mbledhja e KANÇ në Berat, të bëheshin realitet. Për t'ia arritur kësaj, Komiteti Qendror porosiste që Partia të zhvillonte një punë të palodhur për ngritjen e nivelit politik të grave, për t'u dhënë atyre mundësi të fitonin arsim e kulturë, për të zhdukur sektarizmin në pranimin e grave në Parti dhe ngurrimin për ngritjen e tyre në vende drejtuese. Një rol vendimtar për çlirimin e grave do të luante sidomos pjesëmarrja e gjallë e tyre në jetën ekonomike të vendit, në radhë të parë në prodhim.

## **Politika e jashtme**

Forcimi i shtetit të ri demokratik popullor kërkonte edhe forcimin e pozitës së tij ndërkombëtare, të fituar me kontributin që dha populli shqiptar në çështjen e përbashkët të fitores mbi fashizmin. Shqipëria e re nuk mund të ishte më një monedhë shkëmbimi a plaçkë tregu në duart e fuqive të mëdha imperialiste. Ajo hyri në arenën ndërkombëtare si shtet i lirë e sovran.

Në themel të politikës së jashtme të Qeverisë Demokratike u vu miqësia me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore. Miqësinë dhe bashkëpunimin e ngushtë me këto vende Partia e shihte si një faktor të jashtëm shumë

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Fjala në Kongresin II të Rinisë, 16 prill 1945. Vepra, vëll. 3, f. 38.

të rëndësishëm për të siguruar lirinë e pavarësinë kombëtare, për të forcuar pozitën ndërkombëtare të shtetit të ri demokratik. Në mënyrë të veçantë ajo çmonte përkrahjen politike e morale në fushën ndërkombëtare dhe ndihmën ekonomike të Bashkimit Sovjetik. Një rëndësi të madhe i jepte ajo në këtë kohë edhe vendosjes së marrëdhënieve të miqësisë e të bashkëpunimit me Jugosllavinë e re, me popujt e së cilës popullin shqiptar e lidhte gjaku i derdhur në luftën e përbashkët kundër pushtuesve fashistë.

Partia Komuniste e Shqipërisë ndiqte me shqetësim zhvillimin e ngjarjeve në Greqi, ku reaksioni i brendshëm e ndërkombëtar ishte hedhur në sulm të tërbuar kundër Frontit Nacionalçlirimtar Grek, me të cilin popullin shqiptar e lidhte gjithashtu lufta e përbashkët kundër fashizmit. Partia dhe Qeveria Demokratike e Shqipërisë mbajtën një qëndrim internationalist duke u dhënë ndihmë e përkrahje forcave përparimtare greke në luftën e tyre të drejtë për t'i bërë ballë reaksionit dhe për të vendosur demokracinë.

PKSH ishte për vendosjen e marrëdhënieve të rregullta shtetërore edhe me vendet kapitaliste mbi bazën e respektimit të pavarësisë kombëtare dhe të tërësisë tokësore, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të leverdisë ekonomike reciproke. Mbi këtë bazë Qeveria Demokratike bëri përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet me SHBA, Britaninë e Madhe etj. Por ajo ndeshi në politikën agresive të imperialistëve amerikanë dhe anglezë.

Nga qëndrimi armiqësor i pabesë i SHBA dhe i Anglisë Shqipëria nuk u thirr në Konferencën e San-Franciskos për themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ajo nuk u thirr as në Konferencën e Londrës për dëmshpërblimet nga Italia. Përfaqësuesit anglezë dhe amerikanë u përpoqën të pengonin pjesëmarrjen e saj edhe në Konferencën e Parisit për dëmshpërblimet nga Gjermania. Por këtë herë nuk ia arritën qëllimit. Shqipërisë iu njoh e drejta për të marrë dëmshpërblime nga Gjermania. Shqipëria prapë nuk u ftua të merrte pjesë në bisedimet për hartimin e Traktatit të Paqes me Italinë. Në të gjitha këto raste ajo duhej të zinte vendin që i takonte, të fituar me gjak.

SHBA dhe Anglia kërcënonin pavarësinë dhe sovranitetin e vendit. Ato u orvatën me shpifje ta paraqitnin Shqipërinë e re të vogël, që zhvillonte një luftë të vendosur për pa-

qen, lirinë e pavarësinë e popujve, kundër politikës agresive e luftënxitëse imperialiste, si një vend që turbullon paqen dhe sigurimin në Ballkan. Por të gjitha orvatjet e imperializmit amerikan dhe anglez për të minuar pozitën ndërkombëtare të shtetit të ri shqiptar dështuan.

Populli shqiptar i udhëhequr nga Partia i bëri ballë me vendosmëri presionit imperialist. Mbrojtja me guxim e pavarësisë, e të drejtave të tij të ligjshme, e rrugës që kishte nisur dhe qenia e tij në kampin demokratik e antiimperialist e forcuan pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë së re.

## 2. MOBILIZIMI I MASAVE PËR RINDËRTIMIN E VENDIT. SHNDËRRIMET E PARA EKONOMIKO-SHOQËRORE

Në rrethanat e shkatërrimeve që kishte lënë pas lufta një nga problemet më të ngutshme ishte rindërtimi dhe normalizimi i gjithë jetës ekonomike e kulturore të vendit.

Për ta zgjidhur këtë problem nevojiteshin mjete të mëdha materiale e financiare. Përpara PKSH shtrohej çështja: ku do të gjendeshin këto mjete.

**Mbështetja në forcat e brendshme** Gjendjen e vështirë ekonomike të Shqipërisë imperialistët amerikanë e anglezë u munduan ta shfrytëzonin për qëllimet e tyre dhe nxituan të ofronin «ndihmën» e vet. PKSH e hodhi kategorikisht poshtë këtë «ndihmë» skllavëruese dhe zgjodhi rrugën e ndërtimit të vendit duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e brendshme si edhe në ndihmën vëllazërore që do të jepnin Bashkimi Sovjetik me vendet e demokracisë popullore.

Problemin e rindërtimit dhe të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit Partia e bëri çështje të të gjithë popullit. Punëtorët, fshatarët, intelektualët, gratë organizuan kudo skuadra, çeta, batalione e brigada të punës vullnetare. Për të ndihmuar të dëmtuarit nga lufta njerëzit hiqnin kafshatën e gojës, dhuronin para, drithë, veshmbathje e çdo gjë tjetër që mund të shërbente për të lehtësuar vuajtjet e tyre. Qeveria, duke pasur edhe ndihmën e Bashkimit Sovjetik në grurë, i siguroi bukën popullit.



Në kushte shumë të vështira dhe me mungesa të mëdha mjetesh teknike e kuadrosh njerëzit punuan me vetëmohim për ndërtimin në radhë të parë të urave e të rrugëve të prishura dhe për rivendosjen e shpejtë të komunikacionit.

Gjatë vitit 1945, me përpjekjet e punëtorëve u vunë në përdorim dhe filluan nga prodhimi një pjesë e fabrikave e centraleve elektrike dhe e minierave. Partia mobilizoi fshataresinë për mbjelljen e tokës së punueshme dhe për ndërtimin e shtëpive të djegura me ndihmën e madhe të shtetit. Filluan nga puna institucionet arsimore e kulturore, u çelën shkolla të reja sidomos në fshatra. Një fushatë e madhe filloi veçanërisht për zhdukjen e analfabetizmit ndër të rriturit, të kësaj plage shumë të rëndë të së kaluarës. Në këtë fushatë u hodhën në veprim vullnetarisht arsimitarët e vjetër e mijëra arsimitarë të rinj, që u përgatitën në kurse të posaçme.

Gjatë punës së rindërtimit u ndie shumë mungesa e kuadrove teknike të profesioneve të ndryshme. Për mbushjen e shpejtë të këtij boshllëku u çelën kurse për përgatitje teknike dhe për aftësimin më të lartë të punëtorëve.

Barrën më të madhe të veprës së rindërtimit e mori përsipër rinia. Të rinjtë e të rejat e qytetit e të fshatit mbushën të parët radhët e brigadave vullnetare të punës. Ata ishin në ballë të aksioneve për ndërtimin e rrugëve, të urave dhe të shtëpive të djegura, në ballë të luftës për përhapjen e arsimit e të kulturës.

Nga fitimet që kishin nxjerrë gjatë luftës kapitalistët kishin përqëndruar në duart e tyre kapitale të mëdha, kryesisht në ar e stocqe mallrash. Në këto rrethana qeveria e pa të arsyeshme e të domosdoshme që një pjesë e mirë e këtyre fitimeve të kalonte në duart e shtetit dhe të përdorej për nevojat e popullit e të rindërtimit të vendit. Për këtë qëllim në janar të vitit 1945 doli ligji i tatimit të jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës. Tatimi ishte progresiv. Ligji parashikonte gjithashtu që të gjithë atyre, që nuk paguanin tatimin, t'u konfiskohej pa shpërblim pasuria. Ai drejtohej kështu njëkohësisht kundër fuqisë ekonomike të kapitalistëve.

Tregtarët, fabrikantët dhe gjithë ata që tatoheshin bënë shumë përpjekje për t'iu shmangur shlyerjes së tatimit. Ata fshehën mallrat dhe arin e grumbulluar. U munduan ta paraqitnin këtë masë si «grabitje të popullit» dhe përdorën çdo mjet për të ruajtur pasurinë e krijuar në kurriz të punonjësve.

Komiteti Qendror i porositi organizatat e partisë të mos bënin asnjë lëshim dhe të luftonin me këmbëngulje për të zbatuar me rreptësi ligjin. Çdo lëshim në këtë çështje do të dëmtonte prestigjin e pushtetit.

Komisionet përkatëse, të mbështetura nga masat, i detyruan tregtarët dhe gjithë kapitalistët e tjerë të paguanin tatimin e parashikuar nga ligji. Në vitin 1945 të ardhurat nga tatimi i jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës siguruan më shumë se gjysmën e të gjitha të ardhurave të buxhetit të shtetit.

Gjithë kapitalistëve që nuk paguan tatimin iu konfiskua pasuria. Në duart e shtetit u grumbullua kështu një sasi e madhe mallrash të ndryshme. Mbi këtë bazë u krijuan dyqanat e shtetit. Kjo shënoi lindjen e sektorit shtetëror socialist në tregti.

Krahas ligjit të tatimit të jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës, u morën edhe një varg masash të tjera revolucionare. U nxor ligji mbi rekuizimin e sendeve ushqimore dhe të lëndëve të tjera të nevojshme për rindërtimin. Në vend të çmimeve të lira, u vendos sistemi i çmimeve të caktuara. U organizua kontrolli i çmimeve nga populli dhe u zhvillua një luftë e rreptë kundër spekulimit e tregut të zi. Grumbullimi i drithit për shitje nga tregtarët privatë u ndalua. Për grumbullimin dhe shitjen e tij u vendos monopoli i shtetit dhe u caktuan çmime të njësuara për blerjen dhe shitjen e drithit nga shteti. Me anën e vulosjes së bankënotave të vjetra u zbut deri-diku inflacioni, që kishin lënë pas pushtuesit dhe u vendos kontrolli mbi kartëmonedhën e vjetër në qarkullim. Këto masa u përforcuan me vendosjen e kontrollit shtetëror mbi tregtinë e jashtme, e cila më vonë u shndërrua në monopol shtetëror.

Në këtë mënyrë, u zgjidh për një kohë problemi financiar në dobi të rimëkëmbjes së vendit, u normalizua jeta ekonomike dhe njëkohësisht u dobësuan pozitat ekonomike të borgjezisë.

### **Krijimi i sektorit socialist të ekonomisë**

Pushteti popullor nuk mund të mbahej mbi bazën e vjetër ekonomiko-shoqërore. Mbi këtë bazë ai nuk mund të kryente me sukses detyrat e rindërtimit dhe aq më tepër detyrat e zhvillimit të vendit në rruget e socializmit.

Ky zhvillim kërkonte patjetër të bëheshin shndërrime të thella ekonomik-shoqërore dhe të ndërtohej baza e re socialiste e ekonomisë.

Është e vërtetë se fill pas Çlirimit në lëmin e shndërri-meve ekonomik-shoqërore si detyrë e ngutshme qëndronin shndërrimet me karakter demokratik, antiimperialist e anti-feudal, si vazhdim i pashmangshëm e logjik i revolucionit popullor.

Por në kushtet e reja politike, kur pushteti kishte filluar të kryente funksionet e diktaturës së proletariatit, Partia nuk mund të priste dhe nuk priti sa të zgjidheshin tërësisht të gjitha detyrat demokratike dhe pastaj të fillonte nga zgjidhja e detyrave me karakter socialist në fushën ekonomik-shoqërore. Raporti i forcave politiko-klasore në Shqipëri lejonte që, krahas shndërimeve demokratike, të kalohej menjëherë edhe në kryerjen e shndërimeve socialiste.

Nga këto shndërrime më i rëndësishmi dhe vendimtari ishte shoqërizimi i mjeteve kryesore të prodhimit me anën e shtetëzimit të tyre.

Si shkallë e parë dhe masë përgatitore për shtetëzimin e mjeteve kryesore të prodhimit shërbeu kontrolli shtetëror mbi prodhimin e shpërndarjen, që u vendos që në dhjetor 1944. Ky ishte në të njëjtën kohë një formë e kontrollit punëtor. Ai përfshiu sipërmarrjet e kapitalit vendës e të huaj, që kishin rëndësi për gjithë ekonominë popullore.

Kontrolli ushtrohej nëpërmjet komisarëve të caktuar nga shteti.

Punëtorët, të udhëhequr nga Partia me ndihmën e komisarëve, morën pjesë gjallërisht në organizimin e prodhimit dhe në drejtimin e ndërmarrjeve. Ata patën kështu mundësi të provonin forcat e tyre dhe të fitonin shprehje drejtimi të prodhimit. Me anë të kontrollit punëtor u njohën aftësitë prodhuese të ndërmarrjeve, burimet dhe rezervat e lëndës së parë, të materialeve dhe të lëndës djegëse. Kjo e përgatiti klasën punëto-re të merrte ndërmarrjet në dorë dhe t'i drejtonte kur ato u shtetëzuan.

Në dhjetor 1944 u shtetëzuan minierat dhe pasuria e të arratisurve politikë. Një muaj më vonë doli ligji mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve italianë e gjermanë në Shqipëri. Me zbatimin e këtij ligji në duart e shtetit shqiptar kaluan pa shpërblim, si pronë e përbashkët e popullit, Banka Kombë-

tare, bankat e tjera dhe pasuria e 111 shoqërive aksioniste të kapitalistëve të huaj. Në prill 1945, kundrejt një shpërblimi të caktuar, u bë rekuizimi i të gjitha automjeteve të transportit të pronarëve privatë.

Këto shtetëzime patën rëndësi të madhe. Me zhdukjen e pozitive ekonomike të kapitalit të huaj iu dha fund varësisë ekonomike nga fuqitë imperialiste, gjë që forcoi edhe më shumë pavarësinë politike të vendit.

Nga pikëpamja e formës shtetëzimet e vitit 1945 ishin masa me karakter të përgjithshëm demokratik. Kurse nga pikëpamja e përmbajtjes ekonomiko-shoqërore ato përfaqësonin shndërrime që dilnin jashtë këtij caku. Shtetëzimet u bënë në interes të masave punonjëse dhe mjetet e shtetëzuara u vunë në shërbim të plotë e të drejtpërdrejtë të tyre. Prandaj këto shtetëzime ishin në thelb shoqërizim i mjeteve kryesore të prodhimit me karakter socialist. Mbi bazën e tyre në ekonominë popullore lindi sektori shtetëror socialist.

Në korrik 1945 në qytet filluan të ngrihen kooperativat e konsumit për punëtorët e nëpunësit. Këto ishin organizatat e para ekonomike të masave. Në kushtet kur sektori shtetëror në tregti ishte ende shumë i vogël, ato luanin një rol të madh për furnizimin e rregullt të punonjësve të qytetit, për luftën kundër spekulimit dhe tregut të zi. Krahas me ngritjen e kooperativave të konsumit, Partia zhvilloi një punë të madhe sqaruese e bindëse edhe për kooperimin e zejtarëve.

Krijimi i sektorëve socialistë të ekonomisë u shoqërua me masa të rëndësishme në dobi të punëtorëve e nëpunësve. U vu në zbatim dita 8-orëshe e punës. U vendos paga e barabartë për punë të barabartë, pavarësisht nga mosha dhe seksi, si edhe e drejta e pushimit vjetor prej 15 ditësh me shpërblim të plotë. Papunësia pothuajse u zhduk krejt.

Këto fitore revolucionare përmirësuan disi kushtet e jetesës së punonjësve dhe e forcuan truallin për fitore të reja në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit mbi baza socialiste.

## **Për zhdukjen e marrëdhënieve të vjetra agrare**

ishte zhdukja e marrëdhënieve të vjetra agrare. Ky problem kishte të bënte me zgjidhjen në mënyrë rrënjësore të kontra-

Në lëmin e bujqësisë problemi më i mprehtë dhe më i ngutshëm

diktës antagoniste midis fshatarësisë punonjëse dhe pronarëve të mëdhenj të tokës, domethënë me shndërrimin më të madh demokratik që kishte mbetur pa u kryer. Kjo ishte tani fusha kryesore për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë. Prandaj zgjidhjes së kësaj detyre Partia i kushtoi një kujdes të posaçëm.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 1945 u morën disa masa që lehtësonin disi gjendjen e rëndë ekonomike të fshatarësisë punonjëse. Doli ligji, sipas të cilit shfuqizoheshin të gjitha qiratë e vjetra të tokës të mbetura pa u paguar, kurse për vitet 1944 e 1945 qiratë zbritnin deri 75 për qind. Por kjo ishte një masë gjysmake, që nuk gjeti pëlqimin e fshatarësisë së varfër, e cila s'pagoi asnjë përqindje qiraje. Më të rëndësishme ishin: shtetëzimi i sistemit të ujitjes, (më parë pronë private), që iu dha në përdorim të përbashkët fshatarësisë; heqja e të gjitha borxheve me fajde (të krijuara deri në Çlirimin e vendit), që kishin mbytur kryesisht fshatarët e varfër.

PKSH i quante këto masa kalimtare, kurse masa themelore që do të përmbyste gjendjen në dobi të fshatarësisë punonjëse ishte reforma agrare, e cila do t'i jepte asaj tokën. Menjëherë, pas Çlirimit Partia hodhi parullën «Tokën atyre që e punojnë!»

Ligji mbi Reformën Agrare u shpall në gusht 1945. Sipas ligjit, shpronësoheshin dhe tjetërsoheshin çifligjet e shtetit si edhe pronat e institucioneve fetare e gjithë tokat private që e kalonin madhësinë e parashikuar prej tij. Kjo madhësi qe caktuar: deri në 40 ha kur pronari kishte një ekonomi shembullore dhe e drejtonte vetë; 20 ha kur pronari e punonte ose e administronte vetë tokën; 7 ha kur pronari nuk e punonte vetë tokën, por që duhej ta punonte vetë jo më vonë se brenda dy vjetëve.

Në kushtet e Shqipërisë, ku sipërfaqja e tokës së punueshme ishte tepër e kufizuar, sasia e tokës prej 20-40 ha që u lihej pronarëve privatë ishte shumë e madhe. Me këtë sasi mjaft çifligarë ruanin ende pozitën e tyre në fshat, fuqia ekonomike e fshatarit të pasur (kulakut) nuk prekej fare, ndërsa shumë fshatarë të varfër mbeteshin pa tokë. Ky gabim në ligjin e Reformës qe pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të Sejfulla Malëshovës me pikëpamjet e tij oportuniste dhe të përfaqësuesve të PKJ.

Shpronësimi i tokave që kalonin madhësinë e caktuar bëhej pa shpërblim. Ato u shpërndareshin falas, në formën e pronës private, fshatarëve pa tokë dhe me pak tokë. Çdo kryefamiljari i jepeshin deri më 5 ha. Shitja, blerja dhe dhënia me qira e tokës ndalohej.

Një pjesë e tokave të shpronësuara u shndërrua në pronë shtetërore. Në këto toka u krijuan ndërmarrjet bujqësore shtetërore, të cilat shënuan lindjen e sektorit shtetëror socialist në bujqësi. Përveç kësaj, në pronë të përbashkët të popullit u shndërruan pyjet, ujërat dhe pasuritë e nëntokës.

Përpara dhe pasi doli ligji mbi Reformën Agrare, Partia bëri një punë të madhe sqaruese, sidomos me komunistët e fshatit dhe fshatarësinë punonjëse, për qëllimin e kësaj reforme.

Ajo paralajmëroi se reaksioni do të përdorte të gjitha mjetet për të penguar zbatimin e Reformës Agrare, për të ulur entuziazmin e fshatarëve dhe për ta paraqitur Qeverinë Demokratike në sytë e popullit si të paaftë. Komiteti Qendror udhëzonte që Reforma Agrare të shikohej si aksion i madh politik. Zbatimi i saj do ta lidhte edhe më shumë fshatarësinë me Partinë.

Për zbatimin e shpejtë dhe të drejtë të Reformës Agrare Partia krijoi komitetet e fshatarëve të varfër. Ato luajtën një rol të rëndësishëm në përcaktimin e saktë të tokave shtetërore, të çifligarëve e të armiqve të popullit, në regjistrimin e familjeve fshatare pa tokë dhe me pak tokë. Ato ndihmuan në ndarjen e tokave të shpronësuara, sidomos në mobilizimin e fshatarësisë punonjëse për të zbuluar e për të luftuar vepërimtarinë armiqësore të çifligarëve dhe të forcave të tjera reaksionare që u ngritën qysh në fillim kundër Reformës. Krijimi i Komiteteve të fshatarëve të varfër dhe e gjithë puna e tyre ndihmuan shumë për rritjen e ndërgjegjes politike klasore të fshatarësisë së varfër.

### 3. PËRFORCIMI I SHTETIT TË DEMOKRACISË POPULLORE SI FORMË E DIKTATURËS SË PROLETARIATIT

Në shtator 1945 Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar shpalli ligjin mbi zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese.

Sipas ligjit, zgjedhjet, që u vendos të bëheshin më 2 dhjetor 1945, do të ishin demokratike dhe të lira, të përgjithshme,

të barabarta, të drejtpërdrejta dhe të fshehta. Të drejtë votimi kishin të gjithë shtetasit shqiptarë, burra e gra, që kishin mbushur moshën 18 vjeç. Luftëtarët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare e gëzonin këtë të drejtë pavarësisht nga mosha. Ligji përjashtonte nga e drejta e votës ministrat e qeverisë kuislinge, kriminelët e luftës dhe gjithë ata që kishin humbur të drejtat qytetare.

### **Vendosmëria e popullit për të vazhduar rrugën e Partisë**

Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese ishin aksioni më i rëndësishëm politik për Partinë, një provë e madhe e pjekurisë së saj dhe e aftësive të saj organizuese, e lidhjeve të saj me masat dhe e vendosmërisë së popullit për të vazhduar rrugën e Partisë. PKSH u mobilizua e gjitha për të fituar këtë betejë të re politike me parullën «Për Republikën Popullore».

Në Plenumin IV të KQ, që mori në shqyrtim çështjen e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, shoku Enver Hoxha thoshte: «Populli duhet të shohë konkretisht se njerëzit që çliruan atdheun nga okupatori dhe tradhtarët janë në gjendje të qeverisin, janë në gjendje të rindërtojnë dhe të përmirësojnë jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Nga fushata elektorale shokët duhet të dalin me një eksperiencë të madhe, kjo të jetë një shkollë për ta dhe t'i armatosë për zgjidhjen e problemeve të tjera të mëdha që do të hasin përpara»<sup>1</sup>.

Partia dha orientimin që zgjedhjet të ktheheshin në një plebishit të madh popullor, të sigurohej pjesëmarrja e gjithë votuesve dhe fitorja e plotë e Frontit në zgjedhje. Ajo vendosi të paraqitej një listë e vetme e kandidatëve të Frontit. Mirëpo si pasojë e shmangieve oportuniste të Sejfulla Malëshovës, në këtë listë u përfshinë edhe një numër përfaqësuesish të reaksionit, kurse klerit katolik iu propozua koalicioni në zgjedhjet.

Fushatën e zgjedhjeve u munduan ta shfrytëzonin për qëllimet e veta edhe forcat reaksionare të brendshme e të jashtme.

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Raport në Plenumin IV të KQ të PKSH, 17 tetor 1945. Vepra, vëll. 3, f. 164-165.

Duke përfituar nga dispozitat ligjore, në fillim reaksioni i brendshëm vendosi të dilte në zgjedhjet me listat e veta si bllok kundër Frontit. Kur kjo orvatje e parë dështoi, sepse nuk gjeti mbështetje në popull, ai ndryshoi taktikë dhe vendosi bojkotimin e zgjedhjeve, duke i bërë thirrje popullit të abstenonte. Këtë qëndrim mundahej ta përlligjte me gjoja «mungesën e demokracisë», «diktaturën e një partie të vetme». Me këtë qëllim Gjergj Kokoshi, një nga zëdhënësit kryesorë të reaksionit, ish-anëtar i KANÇ, doli në mënyrë demonstrative nga Fronti. Organizata ilegale «Bashkimi Shqiptar» e drejtuar nga kleri katolik reaksionar përdori edhe terrorin në bashkëpunim me kriminelët e arratisur të luftës.

Përfaqësues të tjerë të reaksionit që kishin mbetur në Front s'e ndienin veten aq të fortë sa të krijonin një opozitë të hapët. Prandaj ata vendosën të qëndronin në radhët e tij deri në mbarimin e zgjedhjeve, duke synuar që me flamurin e Frontit të zgjidheshin në Asamble, pastaj në gjirin e saj të krijonin një grup, një opozitë «legale» ose parti më vete.

Frymëzuesit dhe organizatorët e veprimtarisë armiqësore të reaksionit të brendshëm ishin drejtpërdrejt imperialistët amerikanë dhe anglezë, të cilët nuk lanë mjet pa përdorur që Fronti të pësonte një dështim politik në zgjedhjet. Ata hapën një fushatë propagandistike kundër Frontit e PKSH dhe i kërkuan brutalisht Qeverisë Demokratike të lejonte oficerët e misioneve të tyre ushtarake në Tiranë të kontrollonin pa pengesë fushatën e zgjedhjeve etj. Në mënyrë të veçantë përdorën si presion çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike të Shqipërisë. Qeveritë amerikane e britanike njoftuan se do ta njihnin qeverinë shqiptare vetëm kur «të siguroheshin se zgjedhjet do të bëheshin të lira». Kjo ishte një orvatje për të ndërhyrë në punët e brendshme, sepse në fakt ligji dhe gjithë veprimtaria e pushtetit popullor siguronin zgjedhje plotësisht të lira.

Qeveria amerikane paraqiti edhe një kusht tjetër; kërkoi me këtë rast të njiheshin të gjitha marrëveshjet e lidhura midis SHBA dhe Shqipërisë para 7 prillit 1939.

PKSH i hodhi poshtë vendosmërisht të gjitha orvatjet e reja të imperialistëve dhe nuk lejoi asnjë ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë. Ajo demaskoi qëllimet e taktikat e reaksionit të jashtëm e të brendshëm, arriti t'i veçonte forcat kundërshtarë dhe forcoi më shumë bashkimin politik të popullit rreth vetes.



Në valën e fushatës së zgjedhjeve, në nëntor 1945, qeveria e Bashkimit Sovjetik njohu zyrtarisht Qeverinë Demokratike të Shqipërisë. Atë gjithashtu e njohën Jugosllavia e Polonia, pastaj me radhë Bullgaria, Çekoslovakia, Franca e vende të tjera. Kjo e forcoi pozitën ndërkombëtare të pushtetit popullor në Shqipëri dhe e rriti sigurinë ndër masat e popullit për të ardhmen e vendit.

Në zgjedhjet e 2 Dhjetorit morën pjesë rreth 90 për qind e votuesve dhe votuan për kandidatët e Frontit Demokratik 93 për qind. Këto ishin të parat zgjedhje në të gjithë vendin me të gjitha tiparet demokratike. Ato u bënë shkollë e madhe politike për popullin, për Frontin dhe për vetë Partinë. PKSH korri një fitore të madhe, ndërsa reaksioni dështoi.

Me këtë fitore populli i lirë dhe sovran shqiptar shprehu pranimin e plotë të politikës së Partisë dhe vendosmërinë për të ecur i patundur në rrugën e treguar prej saj.

## **Shpallja e Republikës Popullore të Shqipërisë**

Më 11 janar 1946  
Asambleja Kushtetuese, duke shprehur

vullnetin e popullit, e shpalli njëzëri Shqipërinë Republikë Popullore dhe krijoi qeverinë e re me shokun Enver Hoxha në krye.

Projektin e Kushtetutës, të hartuar nga qeveria, PKSH ia shtroi për gjykim gjithë popullit. Diskutimi i këtij projekti zgjati dy muaj. Propozimet e bëra nga masat popullore ishin një kontribut i çmueshëm në forcimin e përmbajtjes revolucionare të Kushtetutës. Më 14 mars 1946, Asambleja e pranoi Kushtetutën. Pas kësaj, Asambleja u kthye në Kuvend Popullor, si organi më i lartë i pushtetit shtetëror të RPSH.

Kushtetuta e re demokratike sanksiononte fitoret historike të arritura dhe pasqyronte ndryshimet që kishin ndodhur në rendin politik dhe ekonomik të vendit pas vendosjes së pushtetit popullor. Ajo mishëronte procesin e filluar të zhvillimit të vendit në rrugën e socializmit dhe hapte perspektiva për shndërrime të reja ekonomiko-shoqërore.

Para së gjithash Kushtetuta përcaktonte parimin themelor të ndërtimit dhe të veprimtarisë së pushtetit popullor: **pushteti buron nga populli dhe i takon popullit.**

Në bazë të Kushtetutës, mjetet kryesore të prodhimit shoqëror përbëheshin prej pasurisë së përbashkët të popullit, prej

pasurisë kooperativiste dhe pasurisë private. Sektori privat i nënshtrohej kontrollit të shtetit.

Si themel i rendit shoqëror-ekonomik caktohej prona shoqërore (sektorët socialistë të ekonomisë — shtetëror dhe kooperativist). Me qëllim që ekonomia socialiste të zhvillohej e të forcohej pa ndërprerje, Kushtetuta përcaktonte të drejtën e shtetit për të kufizuar e për të shpronësuar pronën private, kur këtë e lypte interesi i përgjithshëm shoqëror. Mbi këtë bazë mund të shtetëzoheshin degë të tëra të ekonomisë ose ndërmarrje ekonomike të veçanta. Krijimi i monopoleve, i trusteve dhe i karteleve ndalohej.

Për të mbrojtur interesat jetësore të popullit dhe për të ngritur shkallën e mirëqenies së tij shteti ngarkohej të drejtonte jetën dhe zhvillimin ekonomik në bazë të një plani të përgjithshëm. Për plotësimin e tij shteti mbështetej në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të masave punonjëse.

Kushtetuta e quante punën nder e detyrë të përgjithshme. Ajo shpalli parimin e shpërblimit të secilit sipas punës e aftësisë.

Kushtetuta përmbante parimin e zgjedhjeve të lira, me votim të drejtpërdrejtë, të përgjithshëm, të barabartë dhe të fshehtë. Ajo u jepte të drejtë zgjedhëseve të kërkonin heqjen e përfaqësuesve të tyre nga organet e ndryshme të pushtetit, garantonte lirinë e mbledhjeve, të organizimit, të fjalës e të besimit dhe kushtet e nevojshme për ruajtjen dhe zbatimin e tyre.

Të tilla ishin disa nga parimet themelore të Kushtetutës së parë të Republikës Popullore të Shqipërisë. **Me pranimin e Kushtetutës u përkrye procesi i organizimit politik të rendit të demokracisë popullore si shtet i diktaturës së proletariatit.**

Diktatura e proletariatit, siç e përcakton teoria marksiste-leniniste, përbën një ligjësi të përgjithshme, një domosdoshmëri historike për kalimin nga kapitalizmi në komunizëm. Edhe në Shqipëri ajo do të shërbente si arma kryesore për shkatërrimin e rendit të vjetër shfrytëzues çifligaro-borgjez dhe për ndërtimin e shoqërisë socialiste pa shfrytëzim të njeriut prej njeriut, për ta çuar këtë shoqëri përpara në komunizëm, ku zhduken plotësisht klasat.

Tipari i veçantë ishte se këtu diktatura e proletariatit lindi dhe u zhvillua në formën e shtetit të demokracisë popullore.

Kjo formë diktohej nga kushtet historike të revolucionit, i cili mori një karakter të gjerë e të thellë popullor, si një revolucion antiimperialist demokratik në etapën e parë të tij dhe që, duke u zhvilluar pa ndërprerje, u rrit menjëherë pas çlirimit kombëtar të vendit në revolucion socialist. Diktatura e proletariatit në formën e demokracisë popullore ishte pjellë e këtij revolucioni popullor të pandërprerë, ishte vazhdimi i pushtetit popullor të krijuar në Luftën Nacionalçlirimtare, pas shkatërrimit nga themelet të aparatit shtetëror të pushtuesve e të klasave kryesore reaksionare çifligaro-borgjeze.

Baza politike e diktaturës së proletariatit u bënë këshillat popullorë, vazhduese të drejtpërdrejta të këshillave nacionalçlirimtarë.

Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, që përbën parimin më të lartë të diktaturës së proletariatit, u mishërua në Frontin Demokratik, vazhdues i drejtpërdrejtë i Frontit Nacionalçlirimtar.

Revolucioni antiimperialist demokratik e revolucionin socialist në Shqipëri janë, pra, hallka të një revolucionit të vetëm, të kryer nën udhëheqjen e vetme e të pandarë të partisë marksiste-leniniste të klasës punëtore. Fitorja e pavarësisë së plotë kombëtare dhe vendosja e pushtetit demokratik, që ishte qëllimi strategjik i revolucionit antiimperialist demokratik, vunë themelet dhe krijuan kushtet e domosdoshme për kalimin menjëherë në revolucionin socialist. Në etapën e re të revolucionit Partia përcaktoi si qëllim strategjik të tij **likuidimin e bazës ekonomike të kapitalizmit dhe ndërtimin e bazave të socializmit** nëpërmjet diktaturës së proletariatit.

#### 4. ORIENTIMET E PARTISË PËR THELLIMIN E REVOLUCIONIT DHE NDËRTIMIN E BAZAVE TË SOCIALIZMIT. ZHDUKJA E SHFAQJEVE OPORTUNISTE

Shndërrimet ekonomiko-shoqërore të vitit 1945 përbënin gurët e parë në themelet e zhvillimit të Shqipërisë në rrugën e socializmit. Tani shtrohej çështja të ecej me hapa më të shpejtë në këtë rrugë.

Mirëpo zgjidhja e këtij problemi pengohej nga pikëpamjet dhe qëndrimet oportuniste që ishin shfaqur në zbatimin e vi-

jës së Partisë. Bartës i tyre ishte Sejfulla Malëshova, ish-anëtar i Byrosë Politike të KQ të Partisë. Oportunizmi i Sejfulla Malëshovës ishte shprehje e drejtpërdrejtë e gjunjëzimit përpara presionit të fortë që ushtronin klasat e përmbysura dhe sidomos imperialistët amerikanë dhe anglezë mbi Qeverinë Demokratike e mbi udhëheqjen e PKSH.

Shfaqjet oportuniste qenë kritikuar e dënuar rreptë në mbledhjen e Byrosë Politike të dhjetorit 1945, por Sejfulla Malëshova, ndonëse nuk kishte gjetur asnjë përkrahje, vazhonte të mbronte me këmbëngulje pikëpamjet e tij.

**Plenumi i 5-të i KQ të PKSH** Për të përcaktuar orientimet e Partisë në lidhje me thellimin e revolucionit e me ndërtimin e bazave të socializmit u thirr në shkurt 1946 Plenumi i 5-të i KQ të PKSH.

Plenumi vuri në dukje se vija e Partisë ishte dëmtuar rëndë nga pikëpamjet e theksuara oportuniste që kishte mbrojtur Sejfulla Malëshova në fushën politike dhe ekonomike.

Sejfulla Malëshova shprehte pikëpamjen se rendi i ri demokratik, i vendosur në Shqipëri, duhej të ishte një rend i tipit të demokracisë borgjeze. Ai kërkonte zbutjen e luftës së klasave, mbivlerësonte forcën e klasave të përmbysura dhe nuk kishte besim në forcën e Partisë e të popullit. Ishte për liri të plotë veprimi për sektorin privat kapitalist, për zhvillimin e tij të pakontrolluar e të pakufizuar, shprehej kundër përkrahjes së sektorit kooperativist në qytet e në fshat. Në thelb ai ishte kundër ndërtimit të socializmit dhe mbrojtës i zhvillimit të lirë të kapitalizmit.

Në lëmin e politikës së jashtme, e varte fatin e lirisë e të pavarësisë së Shqipërisë, fatin e pushtetit popullor nga lëshimet politike dhe ekonomike që i duheshin bërë imperializmit amerikano-anglez. Kërkonte të mos bëhej dallim midis BRSS dhe SHBA e Britanisë së Madhe, por të mbahej në marrëdhëniet me ta i njëjti qëndrim.

Me pikëpamjet e veta oportuniste të djathta Sejfulla Malëshova ishte bërë shprehës dhe mbrojtës i interesave të borgjezisë vendëse dhe të imperializmit në gjirin e Partisë, ishte shndërruar në një shërbëtor të tyre. Pa demaskuar e pa luftuar këto pikëpamje rrezikohej vija e Partisë dhe pengohej ndërtimi i socializmit në Shqipëri. Zhdukja e tyre ishte bërë një çështje e ngutshme dhe jetësore.

Plenumi i 5-të i KQ të PKSH i goditi pa lëkundje dhe i hodhi poshtë këto pikëpamje. Meqenëse Sejfulla Malëshova vazhdoi të ngulte këmbë në bindjet e veta, Plenumi e përjash-toi atë nga Byroja Politike dhe nga Komiteti Qendror i Partisë.

Duke shkatërruar oportunitizmin e Sejfulla Malëshovës, Komiteti Qendror e orientoi Partinë drejt thellimit të revolucionit socialist në frontin politik, ekonomik e ideologjik. Ai përcaktoi në vija të përgjithshme drejtimet kryesore për ndër-timin e bazave të socializmit.

Si detyrë e parë u shtrua që industria, tregtia e brendshme e madhe dhe tregtia e jashtme të kalonin plotësisht në duart e shtetit. Në qytet e në fshat do të ngriheshin kooperative e prodhimit e të konsumit. Shteti duhej të ushtronte kontroll të rreptë mbi sektorin privat dhe të kufizonte pa pushim elementët kapitalistë. Kursin që do të ndiqte Partia në ekonomi shoku Enver Hoxha e përcaktoi kështu: «Çdo gjë për forcimin e sektorit të shtetit, luftë të pamëshirshme kapitalit privat, ndihmë sa më të madhe nga ana e shtetit kooperativa-ve të konsumit e të prodhimit...»<sup>1</sup>.

Për zhvillimin e forcave prodhuese dhe për shfrytëzimin e pasurive natyrore u dha orientim i përgjithshëm të krijohej industria socialiste, të shfrytëzoheshin minierat dhe industritë ekzistuese e të krijoheshin miniera dhe ndërmarrje të reja.

Në rrugën e filluar për zhdukjen e marrëdhënieve të vjetra në fshat, u vendos që Reforma Agrare të bëhej rrënjësore, të çohet deri në fund zbatimi i saj dhe të fillohej kolektivizimi i bujqësisë. Njëkohësisht do të ngriheshin ferma shtetërore model. Shteti duhej të ndihmonte me mjete financiare e vegla pune fshatarësinë puncnjëse dhe të kufizonte kulakët. Për zhvillimin e forcave prodhuese në fshat si drejtime të përgjithshme u caktuan mekanizimi i bujqësisë, zhdukja e karakterit të njëanshëm të saj, përhapja e kulturave të reja, zhvillimi i blegtorisë, përmirësimi dhe bonifikimi i tokave.

Për thellimin e revolucionit në fushën e arsimit e të kulturës, si pjesë përbërëse e revolucionit socialist, Plenumi porositi të kryhej reforma arsimore mbi këto themele: arsimit e kultura të bëhen pronë e masave të gjera të popullit e të mos

---

1 Enver Hoxha. Raport në Plenumin e 5-të të KQ të PKSH, 21 shkurt 1946. Vepra, vëll. 3, f. 272.

jenë më privilegj i një pakice, shkolla të zhvishet nga fryma e vjetër e të brumoset me një frymë të re revolucionare. Mbi të gjitha ishte e nevojshme të zhdukej analfabetizmi.

Për ndërtimin e socializmit një rëndësi vendimtare kishte përgatitja e inteligjencies së re të brumosur me botëkuptimin marksist-leninist.

Në lëmin e politikës së jashtme u theksua që Partia të luftonte për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut, për forcimin e miqësisë me BRSS dhe vendet e demokracisë popullore, për mbrojtjen e paqes në botë. Plenumi porosi në mënyrë të veçantë që kundrejt imperializmit amerikan dhe anglez, nga i cili vinte rreziku kryesor për pavarësinë kombëtare dhe rendin demokratik popullor, të mbahej një qëndrim i prerë, i vendosur e parimor.

Për të përballuar detyrat e reja të zhvillimit socialist, armë vendimtare mbetej gjithnjë pushteti popullor. Plenumi dha orientimin që pushteti të forcohej e të demokratizohej jo vetëm në përmbajtjen, por edhe në strukturën e tij, edhe në përbërjen e aparatit administrativ. Specialistët e vjetër, që punonin në këtë aparat, duhej të mbaheshin nën kontroll të vazhdueshëm për të ndaluar futjen e metodave burokratike. Për forcimin e Frontit u dha udhëzim të spastroheshin në mënyrë rrënjësore radhët e tij nga elementët armiq.

Më në fund, kryerja e të gjitha detyrave për thellimin e revolucionit dhe ndërtimin e bazave të socializmit kërkonte patjetër forcimin e vetë Partisë, ngritjen në një shkallë më të lartë të rolit të saj udhëheqës dhe organizues në të gjithë jetën e vendit. Për këtë arsye u pranua ideja e Plenumit të 4-t (tetor 1945) për thirrjen e Kongresit I të Partisë dhe u vendos që ky të mbahej më 25 maj 1946. Mirëpo për shkak të ndërhyrjes së udhëheqjes së PKJ ky vendim nuk u zbatua dhe kongresi u shty për një kohë të pacaktuar.

### **Thellimi i shndërrimeve ekonomiko-shoqërore e kulturore**

Direktivat e Plenumit të 5-të të KQ u pasqyruan menjëherë në Kushtetutën e RP të Shqipërisë, projekti i së cilës në

këtë kohë po shqyrtohej nga populli

Pas Plenumit filloi një fazë e re shtetëzimesh. U bënë shtetërore centralet elektrike, industria e materialeve të ndërtimit dhe e gjithë industria e lehtë dhe ushqimore ekzistue-

se, pronë kryesisht e borgjezisë vendëse. Në fund të vitit 1946 mjetet kryesore të prodhimit në qytet qenë shndërruar në pronë shoqërore, sektorit shtetëror i përkiste 87 për qind e vëllimit të prodhimit të përgjithshëm industrial. Në fund të vitit 1947 prodhimi i industrisë kapitaliste private ishte zhdukur pothuajse plotësisht.

Shoqërizimi socialist i mjeteve kryesore të prodhimit i dha fund sundimit ekonomik të borgjezisë. Ai hodhi themelet ekonomike të diktaturës së proletariatit. Mbi bazën e tij lindën prona shoqërore, marrëdhëniet socialiste në prodhim dhe sektori socialist i ekonomisë në industri, tregti, transport e financë. Ndërmarrjet e shtetëzuara u bënë ndërmarrje socialiste.

Shtetëzimi i mjeteve kryesore të prodhimit në Shqipëri u krye me ritme të shpejta dhe pa shpërblim. Kjo ndodhi si pasojë e diferencimit të thellë klasor që u bë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe pas saj, gjë që shpuri në asgjësimin e sundimit politik të borgjezisë. Me këtë ishte mënjanuar pengesa kryesore për të zhdukur edhe bazën ekonomike të saj.

Masat që kishin marrë me kohë Partia dhe pushteti popullor bënë që shtetëzimi të zbatohet pa tronditje dhe dëmtime ekonomike.

Krahas sektorit socialist shtetëror, u ngrit dhe u zhvillua sektori kooperativist. Gjatë vitit 1946 u krijuan dhjetëra kooperativa të reja konsumi në qytete dhe kooperativa shitblerjeje në fshatra. Deri në fund të këtij viti, në kooperativat e artizanatit u përfshinë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të zejtarëve.

Për të siguruar furnizimin e popullsisë me bukë, në qershor 1946 u vendos sistemi shtetëror për blerjen, grumbullimin dhe shitjen e drithit. Kjo masë u hoqi çdo mundësi tregtarëve privatë që të spekulonin me bukën e popullit.

Në korrik të vitit 1946 u bë Reforma Monetare, duke vendosur kufirin maksimal të shkëmbimit të bankënotave të reja për një familje. Me anën e kësaj mase u hoq nga duart e elementëve kapitalistë një pjesë e mirë e mjeteve monetare dhe u zhdukën pasojat e rënda të inflacionit që godisnin masat punonjëse.

Që të sigurohet një shpërndarje më e drejtë dhe e rregullt e sendeve ushqimore, në shtator 1946, u vu në zbatim sistemi i triskëtimit.

Vendosja e sistemit të triskëtimit ishte e domosdoshme në një kohë kur fondi i sendeve ushqimore ishte i kufizuar. Ky sistem u siguronte masave punonjëse plotësimin e nevojave kryesore dhe i mbyllte rrugën spekulimit me sendet ushqimore të racionuara. Partia ishte e ndërgjegjshme se sistemi i triskëtimit ishte një masë e përkohshme që do të hiqej porsa të krijoheshin kushtet e përshtatshme ekonomike.

Me krijimin e sektorit socialist dhe zgjerimin e tij u bë i domosdoshëm drejtimi dhe rregullimi me plan i gjithë jetës ekonomike të vendit. Në gusht 1946 doli ligji mbi planin e përgjithshëm ekonomik të shtetit dhe mbi organet e planifikimit. Komisioni i Planit, i krijuar më 1945, u riorganizua dhe filloi menjëherë punën për hartimin e planit të përgjithshëm ekonomik për vitin 1947.

Në maj 1946 u bënë ndryshime në ligjin e Reformës Agrare që i jepnin asaj një përmbajtje më të thellë revolucionare. Të gjitha tokat, vreshtat, ullishtat, kopshtet, ndërtesat dhe inventari bujqësor, pronë e atyre që nuk e punonin tokën vetë, shpronësoheshin. Gjithë bujqve dhe pronarëve, që e punonin tokën vetë, u lihej jo më shumë se 5 ha. Ndalohej shitblerja e tokës me çdo titull ose lënia e saj peng.

Me këto ndryshime zbatoheshin plotësisht parimi «toka i përket atij që e punon», zhdukej pronësia e madhe mbi tokën dhe goditej pozita ekonomike e kulakëve.

Këto ndryshime hasën në një kundërshtim të ashpër të klasave shfrytëzuese. Çifligarët dhe kulakët përdorën të gjitha mjetet për të penguar zbatimin e Reformës Agrare. Ata i kërcënonin fshatarët me qëllim që të mos e merrnin tokën që u jepte Reforma, i frikësonin me parullën: «Qeveria nuk do të njihet nga fuqitë e mëdha dhe pushteti popullor do të rrëzohet së shpejti». Kleri reaksionar propagandonte se toka «është e shenjtë» dhe se «kush e prek atë dënohet nga zoti». Në mënyrë të veçantë zhvillonin veprimtari armiqësore një pjesë e teknikëve borgjezë dhe përfaqësuesit e klasave të përmbysura, që kishin depërtuar në komitetet e fshatarëve të varfër, në aparatet e shtetit dhe në organet e bujqësisë. Këta përpiqeshin t'u linin çifligarëve e kulakëve tokën më të mirë ose më shumë se sa u takonte. Pronarët e pasur filluan të therrnin kafshët dhe të shkatërronin veglat e punës, që do t'u shpërndareshin fshatarëve. Në disa raste ata kaluan edhe në veprime të hapta terroriste kundër militantëve të partisë e të



pushtetit. Atyre u erdhën drejtpërdrejt në ndihmë misionet amerikane dhe angleze në Tiranë, të cilat u munduan të sabotonin reformën, veçanërisht në Myzeqe.

Për zbatimin e plotë të Reformës Agrare u vu në lëvizje gjithë Partia, e cila ngriti më këmbë masat e fshatarësisë së varfër dhe organizoi një luftë të ashpër kundër armikut të klasës. Fshatarëve u erdhën në ndihmë edhe punonjësit e qytetit. Në nëntor 1946 Reforma përfundoi në mbarë Shqipërinë. Fshatarët u bënë zotër të vërtetë të tokës, ku kishin punuar e kishin derdhur djersën brez pas brezi. Partia e plotësoi ëndrrën e tyre shekullore. Rreth 90 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të tokës së shpronësuar, gjysma e rrënjëve të ullinjve dhe të gjitha kafshët e punës iu shpërndanë falas 70 000 familjeve fshatare pa tokë dhe me pak tokë.

**Reforma Agrare qe revolucioni i parë në marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore të fshatit.** Thelbi i saj ishte shndërrimi demokratik i marrëdhënieve agrare në fshat. Ajo zhduku pronësinë e madhe mbi tokën, fshiu përgjithmonë nga faqja e dheut mbeturinat e feudalizmit dhe klasën e çifligarëve. Me kufizimin e pronës private mbi tokën, me ndalimin e shitblerjes, të dhënies me qira dhe të lënies së saj peng u pengua shpërbërja e fshatarësisë në dy pole dhe u ngushtuan së tepërmi caqet e shfrytëzimit të saj nga kulakët. Si e tillë, Reforma Agrare përmbante njëkohësisht edhe elemente me karakter të theksuar antikapitalist. Kjo ndodhi për arsye se ajo zbatohet nga diktatura e proletariatit.

Në këto rrethana Reforma Agrare, ndonëse e ruante pronën e vogël private të fshatarëve punonjës mbi tokën dhe e rriste numrin e fshatarëve të mesmë, e kufizonte truallin për zhvillimin e kapitalizmit në fshat.

Zbatimi i Reformës Agrare tregoi se vetëm klasa punëtore dhe partia e saj pas marrjes së pushtetit politik janë në gjendje të kryejnë shndërrime rrënjësore në marrëdhëniet agrare.

Reforma Agrare e forcoi edhe më shumë mbi baza ekonomike aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, forcoi edhe vetë pushtetin popullor, që kishte në themel të tij këtë aleancë. Fshatarët punonjës i shtrënguan më tepër radhët e tyre rreth Partisë dhe krijuan një bindje më të thellë në drejtësinë e vijës së saj politike. E gjithë kjo ishte një mbështetje shumë e rëndësishme për Partinë për të hyrë në rrugën e shndërrimit gradual socialist të fshatit. Puna e PKSH për

përhapjen e ideve të kolektivizimit ndër fshatarët dha përfundimet e saj me ngritjen e kooperativave bujqësore të prodhimit qysh në vitin 1946. Kooperativa e parë u krijua në Krutje të Myzeqesë.

Shndërrimet ekonomiko-shoqërore krijuan kushte të reja që e lehtësonin zhvillimin e revolucionit kulturor, ndërsa detyrat e reja të ndërtimit socialist kërkonin që ky revolucion të zhvillohej me hapa të shpejtë. Revolucioni kulturor gjeti shprehjen e tij në radhë të parë në Reformën Arsimore të gushtit 1946. Sipas kësaj Reforme, arsimi bëhej i përgjithshëm, falas, i barabartë, laik e në gjuhën amtare. Shkollës iu dha karakteri i plotë shtetëror dhe i njëjësuar. Taksat e mësimit u hoqën. Arsimi fillor u bë i detyrueshëm në të gjithë Republikën. Planet, programet dhe tekstet e reja mësimore u hartuan me një përmbajtje të re. U çelën shkolla fillore në çdo fshat. Krahas kësaj u dendësua fushata për zhdukjen e analfabetizmit.

Një problem themelor i revolucionit kulturor dhe i revolucionit socialist në përgjithësi ishte krijimi i inteligjencies së re. Zgjidhja e këtij problemi, në rrethanat kur intelektualët shqiptarë përbënin një numër fare të vogël, kishte rëndësi jetësore. Për këtë qëllim u dërguan shumë bij të popullit për studime të larta jashtë shtetit, sidomos në Bashkimin Sovjetik. Me gjithë vështirësitë ekonomike shteti u krijoi specialistëve kushte të përshtatshme pune, krijimtarie e jetese. Puna ndërtimtare, puna edukuese dhe përkrahja e zjarrtë e Partisë bënë të mundur që shumë nga kuadrot e vjetër të riedukoheshin, të përqafojnë ideologjinë marksiste-leniniste dhe të pranonin rolin udhëheqës të Partisë.

Shndërrimet e reja socialiste në lëmin ekonomik, shoqëror e kulturor u shoqëruan me spastrimin e elementëve armiq nga organet e pushtetit popullor dhe nga organizatat e Frontit Demokratik.

Me ligj të posaçëm u zgjeruan të drejtat dhe detyrat e organeve lokale të pushtetit dhe u krijua Komisioni i Kontrollit të Shtetit. Nëpërmjet tij do të rritej kontrolli i masave punonjëse mbi organet shtetërore dhe mbi veprimtarinë e tyre.

Me masat e reja revolucionare Fronti Demokratik e përmirësoi përbërjen e vet shoqërore. Fronti përfaqësonte tani kryekëput një organizatë politike të masave punonjëse.

Shndërrimet socialiste dhe vrulli revolucionar i masave bënë të mundur që gjatë vitit 1946 të rindërtoheshin objektet

kryesore të shkatërruara nga lufta. Në fund të këtij viti si në industri ashtu edhe në bujqësi prodhimi arriti nivelin e 1938-s. Përveç kësaj, duke u mbështetur kryesisht në punën vullnetare, u ndërmorën edhe vepra të reja. Rinia ndërtoi rrugën automobilistike Kukës—Peshkopi. U tha kënetat e Maliqit, u hapën kanale të reja vaditëse e kulluese etj. Në valën e punës për rindërtimin e vendit u zhvillua iniciativa e veprimtaria krijuese e masave punonjëse, u organizuan garat socialiste dhe lindi lëvizja sulmuese si shprehje e një qëndrimi të ri ndaj punës.

### **Tezat për rishikimin e Plenumit të Beratit**

Plenumi i 5-të i KQ, i cili përpunoi drejtimet themelore të ndërtimit socialist dhe i dha një goditje të rëndë oportunitetit, megjithatë nuk zbuloi dhe nuk zhdukuri burimin e këtij oportuniteti: vlerësimet dhe orientimet e gabuara të Plenumit të 2-të të Beratit. Ai nuk e dënoi as e mënjanoi ndërhyrjen jugosllave në punët e brendshme, nuk e rivendosi unitetin dhe kolegjalitetin në udhëheqjen e Partisë. Si rrjedhim, udhëheqja e gjithë jetës së Partisë dhe të vendit nga ana e Komitetit Qendror haste në pengesa të mëdha. Revizionistët jugosllavë me anë të agjentëve të tyre në PKSH bënë të gjitha përpjekjet për ta mënjanuar Sekretarin e Përgjithshëm nga drejtimi i punëve të Partisë duke përdorur si shkas ngarjesën e madhe me punët shtetërore, si Kryetar i Këshillit të Ministrave. Gjithë udhëheqja e Partisë ishte përqëndruar në fakt në duart e Koçi Xoxes, sekretar organizativ i KQ. Ishte krijuar kështu një dualitet parti-pushtet. Por, në të vërtetë, Koçi Xoxja, duke përdorur autoritetin e Partisë, përpiqej të shtinte në dorë edhe drejtimin e pushtetit. Ai kishte arritur të krijonte një sistem të atillë që urdhëresat, dekretet dhe ligjet mund të zbatoheshin vetëm pasi të jepeshin udhëzime të veçanta të aparatit të KQ të nënshkruara prej tij. Kjo metodë pune kishte dobësuar shumë rolin e organeve shtetërore, ushqente burokratizmin dhe pengonte zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të problemeve.

Në këtë gjendje nuk kishte asnjë garanci për ruajtjen e pastërtisë së vijës së përgjithshme dhe për zgjidhjen me sukses nga Partia të detyrave të mëdha të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë kombëtare.

Shoku Enver Hoxha, i cili nuk kishte qenë asnjëherë i bindur për drejtësinë e vlerësimeve dhe të vendimeve të Plenumit të Beratit, kishte ardhur në përfundim se këto duhej të rishikoheshin dhe të ndreqeshin. Vetëm kështu do të mund të rivendosej uniteti në udhëheqje, të funksiononin normalisht Byroja Politike dhe Komiteti Qendror si organe udhëheqëse të Partisë e të jetës së vendit e të sigurohej zbatimi i orientimeve që dha Plenumi i 5-të për ndërtimin e bazave të socializmit.

Për këtë qëllim, në qershor 1946, ai paraqiti në Byronë Politike një raport të posaçëm për rishikimin e Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror.

Tezat kryesore të këtij raporti ishin:

1. — Përgatitja e punimeve të Plenumit të 2-të u bë duke shkelur rëndë normat e jetës së brendshme të Partisë. Çështjet që u paraqitën për shqyrtim në Byronë Politike para Plenumit nuk u shtruan në mënyrë shoqërore e komuniste, por u vendosën jashtë Byrosë, pa një analizë të thellë marksiste-leniniste, me pasione dhe paragjykime, pa iu nënshtruar më parë një rrahjeje të lirë mendimesh. Ato u shtruan në formën e «grush-tit të shtetit».

2. — Vlerësimet dhe konkluzionet e Plenumit të Beratit janë kryekëput të gabuara.

3. — Etapën e shkëlqyer të Luftës Nacionalçlirimtare Plenumi i Beratit «e errësoi, e përçmoi, e dënoi».

4. — U cenua rëndë pavarësia e PKSH.

5. — Përgjegjësit kryesorë janë Velimir Stojniçi dhe Sejfulla Malëshova. «Velimir Stojniçi luante me Partinë tonë dhe me njerëzit tanë». Ai «i drejtoi dhe bëri të merrnin drejtim të shtrembër punimet e Plenumit».

6. — Orientimet e Plenumit të Beratit patën pasoja të rënda për Partinë dhe, po të vazhdojnë, do të bëhen rrezik i madh për të.

Shoku Enver Hoxha ende nuk dinte gjë për prapaskenën e Beratit, për komplotin që kishte kurdisur udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave, për të gjithë pjesëtarët e këtij komploti. Ai cilësonte si përgjegjës kryesorë Velimir Stojniçin dhe Sejfulla Malëshovën meqenëse ata kishin mbajtur flamurin e sulmit antiparti në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror. Të tjerët, Koçi Xoxe, Pandi Kristo e Nako Spiru në raport vetëm kritikoheshin për mbështetjen që i kishin dhënë Velimir Stojniçit e Sejfulla Malëshovës. Por edhe pa e ditur prapaskenën,

shoku Enver Hoxha, duke i analizuar me syrin e marksistit punimet e Plenumit të Beratit, kishte formuar bindjen kategorike se në këtë Plenum vija e Partisë që dënuar pa kurrfarë të drejte e arsyeje, se Partia s'kishte gabuar politikisht, se vija e saj kishte qenë e drejtë. Prandaj ai kërkonte që vendimet e këtij Plenumi të hidheshin poshtë, të vihej në vend e vërteta historike dhe të mënjanoheshin rreziku që i kanosej pavarësisë së Partisë dhe vijës së saj marksiste-leniniste.

Këto teza të drejta të shokut Enver Hoxha u kundërshtuan në Byro e nuk u pranuan nga Koçi Xoxja e Pandi Kristoja. Ata kishin frikë se shqyrtimi i hollësishëm dhe pranimi i këtyre tezave do të nxirrte në shesh punën e tyre antiparti dhe ndërhyrjen armiqësore të PKJ në punët e brendshme të PKS. H.

As Nako Spiru nuk pati guximin të zbulonte haptazi vepërimitarinë e vet dhe të pjesëtarëve të tjerë në organizimin e prapaskenës. Duke menduar se gabimin e tij në Berat do ta mbulonte koha dhe fajin do ta shlyente me punë, Nako Spiroja, pas paraqitjes së tezave të shokut Enver Hoxha, filloi të bënte një kthesë dhe të përkrahte në çdo rast pikëpamjet e drejta të Sekretarit të Përgjithshëm. Pas kësaj, ai luftoi me vendosmëri për vijën e Partisë në çështjen e ndërtimit të socializmit.

Pasi tezat e paraqitura në raport nuk u pranuan, shoku Enver Hoxha, gjithnjë me qëllim që të krijoheshin kushte për ndreqjen e gabimeve dhe për vendosjen e unitetit në Byronë Politike, kërkoi që kjo të zgjerohej me anëtarë të rinj të sprovuar në luftë e në punë. Por edhe ky propozim u kundërshtua nga Koçi Xoxja e Pandi Kristoja dhe nuk u pranua plotësisht.

### **Përpjekjet për normalizimin e jetës së brendshme të Partisë**

Kushtet e reja që u krijuan në vend pas triumfit të revolucionit popullor, detyrat e reja historike që i dilnin përpara Partisë, kërkonin zhdukjen e kufizimeve të kohës së luftës në demokracinë e brendshme të partisë, zbatimin e të gjitha normave marksiste-leniniste në jetën organizative. Por ndërhyrja e udhëheqjes jugosllave, kopjimi i formave dhe metodave trockisto-revizioniste të saj nga ana e Koçi Xoxes nuk lejonin një gjë të tillë dhe kishin sjellë shmangie e të meta të theksuara në vijën organizative. Për të ndrequr të metat e për të normalizuar gjendjen, shoku Enver Hoxha propozoi të bëhej një analizë e punës organizative të partisë

dhe e marrëdhënieve midis Partisë dhe pushtetit. Për këtë çështje u ngarkua të paraqiste një raport në Byronë Politike Koçi Xoxja. Mirëpo me shtytjen e udhëheqjes së PKJ ai iu shmang këtij raporti dhe nuk e paraqiti asnjëherë. Arsyeja ishte që të mos goditej Koçi Xoxja, drejtpërdrejt përgjegjës i shtrembërimeve në çështjet organizative, të mos dilte në shesh ndërhyrja e udhëheqjes jugosllave dhe të mos prekej vija e shtrembër që po i impononte ajo PK të Shqipërisë.

Me kërkesën këmbëngulëse të shokut Enver Hoxha dhe të shokëve të tjerë të udhëheqjes, Komiteti Qendror mori, megjithatë, disa masa për normalizimin e jetës organizative të Partisë. Në mungesë të statutit, ai nxori udhëzime të hollësishme që rregullonin jetën e brendshme të Partisë, pranimin e anëtarëve të rinj, marrëdhëniet e Partisë me pushtetin dhe organizatat e masave. Por në këto udhëzime nuk flitej fare për zgjedhjet e organeve të partisë. Më vonë, në mars 1947, Komiteti Qendror vendosi të bëheshin zgjedhje vetëm për sekretarët e celulave. Por edhe këtu nuk u zbatuan të gjitha rregullat organizative. Sekretarët u zgjodhën me votim të hapët. Për byrotë dhe komitetet e partisë nuk u zhvilluan zgjedhje.

Për jetën e brendshme të Partisë një rëndësi të posaçme patën spastrimi i radhëve të saj (revizioni), që u krye gjatë vitit 1946, dhe shpërndarja e tesarave. Në përfundim të revizionit u përjashtuan nga Partia 1246 vetë që përbënin 10 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve e kandidatëve. Midis tyre kishte mjaft që nuk ishin të denjë për titullin e lartë të anëtarit të partisë. Mirëpo revizioni nuk u bë plotësisht sipas rregullave organizative marksiste-leniniste. Për shkak të një vargu gabimesh, në Parti mbetën prapë anëtarë jo të denjë, ndërsa të tjerë u përjashtuan padrejtësisht.

Pas revizionit numri i anëtarëve të partisë filloi të rritej me të shpejtë. Brenda një viti ai u shtua më tepër se tri herë e gjysmë. Nga njëra anë kjo tregonte rritjen e autoritetit të Partisë, nga ana tjetër, e dobësonte përbërjen dhe shpirtin luftarak të saj, për arsye se u tregua kujdes vetëm për shtimin e numrit dhe u la pothuajse pas dore çështja e cilësisë. Kjo bëri që të hynin përsëri në Parti njerëz krejt të huaj ose edhe armiq. Ndërkaq, për pranimin e grave, sidomos në fshat, u mbajt qëndrim sektar.

Krahas përpjekjeve për të normalizuar jetën organizative të Partisë, Komiteti Qendror mori masa edhe për ngritjen e

nivelit teorik të komunistëve, i cili ishte mjaft i ulët. Kjo gjë bëhej edhe më e ngutshme, për arsye se shumë organizata partie nuk e ndienin si nevojë të domosdoshme studimin e teorisë marksiste-leniniste. Për këtë qëllim u hapën kurse e rrethe teorike dhe u organizua studimi individual. Përveç kësaj, u zgjerua agjitacioni e propaganda me masat popullore, duke përdorur forma dhe mjete të reja.

**Ashpërsimi i luftës së klasave** Thellimi i revolucionit ndeshi në qëndresën e

ashpër të armiqve të klasës. Imperialistët dhe reaksioni i brendshëm, me gjithë disfatat e pësuar në Shqipëri, nuk mund të pajtoheshin me ekzistencën e pushtetit popullor, as me shndërrimet revolucionare ekonomiko-shoqërore. Pasi u dështoi synimi që i kishin vënë vetes të arrinin me rastin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, qeveritë amerikane dhe angleze hartuan një plan të ri masash kundër RPSH, për krijimin e një gjendjeje të nderë në vend. Në këtë gjendje do të kurdiseshin ndodhi të tilla që t'u jepnin shkas imperialistëve për ndërhyrje të armatosur nga jashtë dhe për të përligjur këtë ndërhyrje përpara opinionit publik ndërkombëtar.

Kështu, propaganda imperialiste shpërtheu një fushatë të tërbuar kundër rendit të demokracisë popullore, duke i bërë thirrje popullit shqiptar të ngrihej kundër tij. Agjenturat anglo-amerikane grumbulluan në kampe të posaçme në Greqi dhe Itali fashistët, zogistët e ballistët e arratisur jashtë vendit dhe organizuan me ta stërvitje ushtarake e diversioniste, duke i përgatitur për sulmin e afërt të përbashkët, që do të ndërmerrej nga jashtë e nga brenda kundër «komunistëve». Në ujërat tokësore të RPSH patrullonin në mënyrë demonstrative anije luftime britanike, të cilat qëllonin me armë herë pas here në drejtim të tokës shqiptare.

Ndërkaq, misionet ushtarake amerikane dhe angleze në Shqipëri vunë në lëvizje reaksionin e brendshëm. Ato organizuan në një grup të veçantë disa reaksionarë që qenë zgjedhur deputetë në dhjetor 1945. Këta deputetë filluan të shpreheshin hapur kundër shndërrimeve socialiste dhe përpiqeshin të krijonin gjithfarë pengesash në pranimin dhe zbatimin e ligjeve.

Misioni amerikan posaçërisht kishte marrë përsipër çorganizimin e ekonomisë me anë të sabotimeve në objektet kryesore të ndërtimit e të prodhimit. Grupe sabotatorësh, të përbërë prej

specialistësh borgjezë të shitur, vepronin nën drejtimin e tij në Maliq (ku punohej për tharjen e kënetës), në kantieret për ndërtimin e urave, në ndërmarrjen e vajgurit të Kuçovës, në minierën e bakrit të Rubikut e gjetkë.

Në shtator 1946 bandat kundërrevolucionare kryen një goditje të armatosur në qytetin e Shkodrës. Kjo goditje që llogaritur të shërbente si pikënisje për ndërhyrjen ushtarake të jashtme. Mirëpo llogaria nuk u doli armiqve, sepse bandat reaksionare u asgjësuan brenda ditës. Në tetor imperialistët organizuan kundër Shqipërisë një provokacion me karakter ndërkombëtar. Në kohën kur një grup anijesh luftarake angleze përshkonte tejpërtej bregdetin shqiptar me qëllim të hapur provokimi, dy prej tyre u ndeshën në mina detare të mbetura nga koha e luftës në Kanalin e Korfuzit dhe u dëmtuan. Duke paditur Qeverinë Demokratike të Shqipërisë për vendosjen gjoja prej saj të këtyre minave në kanal, qeveritë britanike dhe amerikane u përpoqën ta përdornin ndodhinë e Korfuzit si një mjet që të përgatisnin opinionin për të përligjur zbatimin e trupave të tyre ushtarake në Shqipëri. Ndërkaq, qeveria monarkofashiste greke i kishte bërë më të shpeshta provokacionet tokësore dhe ajrore në kufijtë shtetërorë me RPSH.

Dëndësimi i veprimtarisë së imperialistëve dhe të reaksionit të brendshëm e kishte rritur rrezikun që i kanosej revolucionit popullor në Shqipëri. Por PKSHE dhe masat punonjëse, që kishin fituar një përvojë të madhe në luftën me armiqtë e klasës, të brendshëm dhe të jashtëm, qëndronin gjithnjë syhapur dhe të gatshëm, për t'i bërë ballë çdo rreziku. «Grupi i deputetëve» dhe armiqtë e tjerë brenda vendit nuk gjetën mbështetje në masat. Punonjësit e qytetit e të fshatit morën pjesë gjallërisht tok me organet e Sigurimit të Shtetit dhe repartet ushtarake për zbulimin e armiqve dhe për shfarosjen e tyre. Tradhtarët e sabotatorët u nxorën përpara gjykatave popullore, ku dhanë llogari dhe morën ndëshkimin që u takonte. Ata u detyruan të nxirrnin krejt në shesh planin e kurdisur nga qeveritë amerikane e britanike kundër RPSH dhe të pranonin botërisht tradhtinë.

Në të njëjtën kohë dështoi edhe synimi që kërkonin të arrinin imperialistët me provokacionin e Kanalit të Korfuzit. Megjithëse vunë në veprim organizatat ndërkombëtare, vegla të bindura të tyre, si Gjyqi i Hagës etj., ata nuk arritën të bindnin opinionin ndërkombëtar që Shqipëria të kishte qenë



me të vërtetë faktore për ndodhinë e Korfuzit. Qeveria Demokratike e RPSH e vërtetoi përpara gjithë botës se nuk kishte asnjë faj për këtë ndodhi, se kjo përbënte një provokacion të organizuar me qëllime armiqësore nga qeveria britanike kundër RPSH.

Bindjen e popullit shqiptar se SHBA dhe Britania e Madhe vepronin si armiq të betuar të tij, e forcuan edhe përpjekjet këmbëngulëse të qeverive amerikane dhe angleze për t'i mohuar RPSH vendin e ligjshëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ata përdorën veton në Këshillin e Sigurimit kundër pranimin të Shqipërisë në këtë organizatë.

Imperialistët amerikanë e anglezë u përpoqën me çdo mënyrë të pengonin edhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e Paqes, që u hap në Paris në korrik 1946, por nuk ia arritën qëllimit.

Për të shfaqur pikëpamjen e qeverisë shqiptare për Traktatin e Paqes me Italinë, në Paris vajti një delegacion i kryesuar nga shoku Enver Hoxha. Delegacioni kërkoi: Italia të detyrohej të respektonte jo vetëm sovranitetin dhe pavarësinë e shtetit shqiptar, siç propozohej në projekttraktat, por edhe tërësinë tokësore të tij; Shqipërisë t'i kthehej ari i grabitur nga pushtuesit gjermanë dhe t'i jepeshin dëmshpërblime nga Italia; RPSH të quhej si fuqi shoqe. Këto kërkesa të ligjshme u hodhën poshtë nga Konferenca nën presionin e delegacioneve angleze e amerikane, por me këmbënguljen e Qeverisë Demokratike kërkesat shqiptare u pranuan nga Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha aleate në nëntor 1946.

Përfaqësuesit anglo-amerikanë u orvatën gjithashtu të detyronin Konferencën e Paqes të shqyrtonte rivendikimet tokësore të Greqisë kundrejt Shqipërisë dhe ta cilësonte këtë si «shtet të mundur», por qëndrimi i prerë i delegacionit shqiptar bëri që edhe kjo orvatje të dështonte.

«Unë deklaroj solemnisht, — tha shoku Enver Hoxha, — se as Konferenca e Parisit as Konferenca e të Katërve as çdo konferencë tjetër qoftë nuk mund të marrë në shqyrtim kufijtë e vendit tonë, brenda të cilëve nuk ka asnjë pëllëmbë tokë të huaj. Kufijtë tanë janë të padiskutueshëm dhe askush nuk do të guxojë t'i prekë... E gjithë bota ta dijë ... se populli shqiptar nuk e ka dërguar delegacionin e tij në Paris për të dhënë llogari, por për t'u kërkuar llogari atyre që e kanë dëm-

tuar aq tepër dhe që ai i ka luftuar me aq ashpërsi gjer në fund»<sup>1</sup>.

Për mbërritjet e RPSH në arenën ndërkombëtare, një rol të rëndësishëm luajti përkrahja që i dhanë asaj shtetet miq, veçanërisht Bashkimi Sovjetik.

Nga përvoja e luftës kundër reaksionit në vitet e para pas Çlirimit PKSH nxori mësimet të rëndësishme. Komunistët u bindën edhe në praktikë, bindën njëkohësisht edhe masat punonjëse se revolucioni mund të zhvillohet dhe socializmi mund të ndërtohet vetëm nëpërmjet «një lufte të ashpër dhe të pamëshirshme kundër armiqve tanë të brendshëm dhe përkrahësve të jashtëm imperialistë»<sup>2</sup>. Partia nuk u deh asnjëherë nga fitoret që korrën masat popullore nën udhëheqjen e saj dhe nga dështimet që pësuan armiqtë. Komiteti Qendror mësonte që «puna e armikut duhet të çmohet seriozisht dhe për këtë duhet vigjilencë, një vigjilencë e vazhdueshme dhe revolucionare»<sup>3</sup>.

## **Ndryshimi i strukturës ekonomike e shoqërore dhe përfundimet e para në zhvillimin socialist të ekonomisë**

Shoqërizimi i mjeteve kryesore të prodhimit dhe Reforma Agrare e ndryshuan strukturën ekonomi-

ke e shoqërore të vendit në dobi të socializmit. Ekonomia përbëhej tani nga tri forma kryesore: socialiste, e prodhimit të vogël të mallrave dhe kapitaliste.

Forma socialiste përfshinte industrinë, minierat, central elektrike, transportin e ndërlidhjen, sistemin financiar, tregtinë e jashtme, tregtinë e brendshme me shumicë, ndërmarrjet shtetërore e kooperativiste të tregtisë me pakicë, ekonomitë shtetërore e kooperativiste në bujqësi, stacionet e makinave e të traktorëve, pyjet, ujërat dhe nëntokën. Në fund të vitit 1947 kjo formë zotëronte pozitat komanduese të ekonomisë. Në prodhimin e përgjithshëm industrial pesha e saj arrinte 95 për qind.

---

1 Enver Hoxha. Deklaratë dhënë përfaqësuesve të shtypit në Paris 16 shtator 1946. Vepra, vëll. 3, f. 448-449.

2 Udhëzime të KQ të PKSH, 17 qershor 1947. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 456.

3 Po aty, f. 458.

Prodhimi i vogël i mallrave përfshinte pjesën më të madhe të popullsisë së zënë në punë dhe përfaqësonte rreth 80 për qind të vëllimit të përgjithshëm të prodhimit të ekonomisë kombëtare. Ai përbëhej nga ekonomitë e fshatarëve të varfër e të mesmë dhe të zejtarëve që nuk përdornin fuqi punëtore me mëditje. Të gjithë këta jetonin kryesisht me të ardhurat e punës së tyre.

Forma kapitaliste përbëhej nga ekonomitë e kulakëve në fshat, të tregtarëve e matrapazëve dhe të zejtarëve e sipërmarrësve të vegjël në qytet, që përdornin fuqi punëtore me mëditje. Pesha e saj në vëllimin e përgjithshëm të ekonomisë kombëtare ishte rreth 5 për qind. Ajo që përqendruar kryesisht në fushën e qarkullimit. Në vitin 1947 tregtia private përfaqësonte rreth 80 për qind të vëllimit të përgjithshëm të qarkullimit të mallrave me pakicë.

Këtyre tri formave të ekonomisë u përgjigjeshin edhe tri klasa shoqërore: klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe borgjezia. Klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse ishin bërë dy klasat kryesore të shoqërisë. Borgjezia, me humbjen e pushtetit politik dhe të mjeteve kryesore të prodhimit, që shndërruar në një klasë jokryesore. Por për të mbrojtur interesat e veta klasore ajo zhvillonte një luftë të ashpër kundër pushtetit popullor dhe ndërtimit socialist të vendit. Në këtë luftë ajo kishte edhe mbështetjen e imperializmit ndërkombëtar.

Por Partia ishte e bindur se do të dilte fitimtare mbi armiqtë e klasës, të brendshëm e të jashtëm, dhe do të zgjidhte me sukses detyrat e mëdha të ndërtimit socialist.

Faktorë vendimtarë që siguronin zgjidhjen e këtyre detyrave ishin: vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë dhe udhëheqja e saj e pandarë në gjithë jetën e vendit; diktatura e proletariatit; bashkimi i shëndoshë i masave punonjëse të qytetit e të fshatit rreth Partisë në Frontin Demokratik; kalitja revolucionare e këtyre masave, e fituar në luftën për çlirimin kombëtar e shoqëror dhe për mbrojtjen e fitoreve të arritura në këtë luftë. Një ndihmë e madhe për Partinë ishin përvoja e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, përkrahja politike, ekonomike e morale e tij dhe e vendeve të demokracisë popullore; mbështetja në lëvizjen komuniste e punëtore dhe çlirimtare botërore.

Partia mbante parasysh njëkohësisht edhe pengesat e vësh-tirësitë që rridhnin jo vetëm nga veprimtaria kundërrevolucio-nare e armiqve të klasës, por edhe nga kushtet objektive të brendshme e të jashtme, në të cilat duhej ndërtuar socializmi. Të tilla kushte ishin: gjendja agrare, gjysmëfeudale e vendit; prapambetja e theksuar arsimore e kulturore e popullsisë; mungesa e një klase punëtore të zhvilluar industriale; mungesa e kuadrove inxhiniero-teknikë; burimet e pakta materiale e finan-ciare; rrethimi i vendit nga imperialistët dhe nga ato shtete fqinje që mbanin qëndrim armiqësor.

Në këto rrethana, për ndërtimin e socializmit Partia shtroi si detyrë të parë zhvillimin e shpejtë të forcave prodhuese, duke vënë në veprim e duke përdorur të gjitha mundësitë e burimet e brendshme. Zgjidhja e kësaj detyre përbënte njëkohësisht edhe një kusht vendimtar për kufizimin dhe zhdukjen e ele-mentit kapitalist, për ndërtimin e bazës materiale të socializmit dhe për zgjerimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim.

Ndryshimet në strukturën ekonomike dhe shoqërore të vendit i dhanë mundësi PKSË të merrte masa konkrete për zhvillimin me plan të ekonomisë dhe të kulturës. Planet e para të viteve 1947-48 synonin forcimin e ekonomisë socialiste, duke zhvilluar në radhë të parë minierat dhe degët e industrisë së lehtë. Në lëmin e bujqësisë parashikohej zgjerimi i sipërfaqes së tokave të mbjella, shtimi i prodhimit të drithërave të bukës dhe përhapja e bimëve të reja industriale. Në fushën e kulturës vendin kryesor e zinin përhapja e arsimit, zhdukja e analfabe-tizmit dhe përgatitja e specialistëve.

Për të përballuar detyrat e drejtimit të planifikuar të eko-nomisë, KQ i Partisë dhe Qeveria zbatuan gjatë vitit 1947 një varg masash. Ndërmarrjet industriale shtetërore kaluan mbi baza të llogarisë ekonomike. Kjo ishte një metodë e re e drej-timit me plan të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve, e cila kërkon që ndërmarrja me të ardhurat e siguruara nga shitja e produktit të mbulojë të gjitha shpenzimet e bëra për pro-dhimin e tij dhe në të njëjtën kohë të japë një sasi akumulimi.

Kalimi i ndërmarrjeve ekonomike mbi baza të tilla u plotë-sua edhe me organizimin e punës me norma si edhe me sistemin e ri të shpërblimit sipas punës.

Për centralizimin e akumulimit dhe të shpërndarjes u bë riorganizimi i sistemit financiar, i buxhetit, i tatimeve dhe i funksioneve të bankës. Në vend të karakterit të tij pothuaj ad-

ministrativ, buxheti u shndërrua në plan financiar kryesor të mbarë ekonomisë popullore. Tatimet e humbën gjithashtu karakterin e tyre fiskal. Si forma kryesore e të ardhurave të buxhetit u caktuan tatimi mbi xhiron e ndërmarrjeve ekonomike dhe teprica e fitimeve të tyre. Banka u bë qendra e vetme e kredisë dhe e llogarisë.

Të drejtat dhe detyrat e punëtorëve u përcaktuan në ligjin e ri për punën dhe sigurimet shoqërore të punonjësve. Ky ligj rregullonte gjithashtu lidhjen e kontratave kolektive midis drejtorisë së ndërmarrjes dhe punëtorëve, shpërblimin e punës, kohën e punës dhe të pushimit. Ai mbronte veçanërisht të drejtat e fëmijëve të mitur dhe të gruas, si punëtore e si nënë. Çdo punonjës përfitonte nga sigurimet shoqërore që jepeshin nga shteti në rast sëmundjeje e fatkeqësie në punë, në pleqëri, gjatë barrës dhe për lindje.

Duke çmuar drejt rolin e sektorit kooperativist për ndërtimin e ekonomisë socialiste, Partia goditi shtrembërimet që përbenin një shmangie të hapët nga vija ekonomike e saj.

U ndalua ndarja e gjithë fitimit midis anëtarëve të kooperativave të artizanatit pa hequr mënjatë asgjë për zgjerimin e prodhimit dhe u vendos në to shpërblimi i punës mbi baza socialiste.

U ndalua kategorikisht që mallrat e grumbulluara nga kooperativat e konsumit në qytet t'u rishiteshin tregtarëve privatë, siç ndodhte në raste të veçanta.

Kooperativat e shitblerjes u ngarkuan jo vetëm të shpinin në fshat mallra industriale, por edhe të grumbullonin produkte bujqësore, për të furnizuar rregullisht qytetin. Kjo masë mënjante ndërmjetësit dhe spekulatorët privatë.

Marrja e këtyre masave në sektorin kooperativist kishte rëndësi ekonomike dhe politike. Ato ndihmuan për ta vënë lëvizjen kooperativiste mbi baza të drejta e të shëndosha dhe për t'i prerë rrugën shfrytëzimit të të metave nga ana e elementëve kapitalistë, që luftonin vijën ekonomike të Partisë për ndërtimin e socializmit.

Pa nënvleftësuar rolin dhe rëndësinë e kooperimit në fushën e qarkullimit, Partia e quante këtë vetëm si shkallë fillestare, si një pikënisje për të kaluar në kooperimin në fushën e prodhimit bujqësor. Në përputhje me këtë gjatë viteve 1947-1948 vazhdoi puna për ngritjen mbi baza vullnetare të kooperativave bujqësore të prodhimit.

Që kooperativat e para bujqësore të bëheshin ekonomi socialiste shembullore e moderne, ato kishin nevojë për një bazë materialo-teknike të përparuar. Për këtë qëllim në vitin 1947 u ngritën stacionet e para të makinave dhe të traktorëve (SMT).

SMT-të u krijuan që në fillim si ndërmarrje socialiste shtetërore në bujqësi. Ato u përdorën si një formë e veçantë e ndihmës së madhe që shteti i jepte fshatarësisë në mënyrë të organizuar për lindjen dhe për forcimin e rendit të ri kooperativist në fshat. SMT-të ishin guri i parë në themelet për krijimin e bazës së re materialo-teknike të bujqësisë socialiste. Ato ishin një mjet i fuqishëm ekonomik, politik dhe organizativ për shndërrimin socialist të fshatit.

Një problem i madh ekonomik e politik për Partinë dhe pushtetin ishte sigurimi i bukës. Për zgjidhjen e tij pushteti popullor që i shtrënguar të nxirrte urdhëresa të posaçme, sipas të cilave prodhuesit fshatarë detyroheshin t'i shisnin shtetit të gjitha tepricat e drithit, pasi të mbanin sasinë e nevojshme të caktuar me ligj për farën e për ushqimin e familjes.

Shteti mundi të grumbullonte kështu sasinë e nevojshme të drithit. Por zbatimi i urdhëresave hasi në vështirësi të shkaktuara nga kundërshtimi i fshatarëve prodhues dhe nga orvatjet e armiqve për ta shfrytëzuar këtë kundërshtim në dobi të tyre. Nga ana tjetër, ky sistem grumbullimi nuk ngjallte te fshatari asnjë interes ose nxitje materiale që ai të shtonte sipërfaqen e mbjellë dhe prodhimin bujqësor. Për këto arsye, gjatë vitit 1948, u bënë ndryshime në sistemin e grumbullimit të drithit. Tani çdo ekonomie fshatare i caktohej sasia e drithit që ajo duhej t'i dorëzonte detyrimisht shtetit me çmime të njësuara. Tepricat mbi këtë sasi fshatarët mund t'i mbanin për vete ose mund t'ia shisnin shtetit me çmime më të larta se ato të grumbullimit të detyrueshëm. Ky sistem krijonte deri-diku për fshatarin njëfarë nxitjeje materiale për shtimin e prodhimit bujqësor. Por ai nuk e zgjidhte plotësisht problemin, sepse linte shteg për shtrembërime që çonin ose në grumbullimin e detyruar të të gjitha tepricave të prodhimeve ose në lënien e tyre në sasi më të mëdha nga sa parashikonin urdhëresat.

Ndryshimet e shpeshta të sistemit të grumbullimit gjatë viteve 1946-1948 ishin pasojë jo vetëm e vështirësive për sigurimin e bukës, por edhe e mungesës së përvojës për të gjetur format më të përshtatshme të lidhjeve ekonomike midis qytetit e fshatit, si edhe e ndërhyrjes jugosllave.

Gjatë viteve 1947-1948 masat punonjëse bënë përpjekje të mëdha për plotësimin e planeve. Në këta dy vjet u ndërtuan vepra të reja industriale, hekurudha Tiranë—Durrës—Peqin dhe u zgjeruan aftësitë prodhuese të minierave. Më 1948 prodhimi i përgjithshëm industrial ishte dy herë më i madh se i vitit 1938.

Në këtë kohë edhe prodhimi bujqësor e kaloi nivelin e paraluftës. Filloi të ndryshonte dalngadalë, por në mënyrë të vendosur, struktura e vjetër e bujqësisë me përhapjen e kulturave të reja industriale. U bënë hapat e parë për tharjen e kënetave, për kullimin dhe ujtitjen e tokave.

Shndërrimet ekonomiko-shoqërore me karakter demokratik e socialist që u kryen në Shqipëri fill pas Çlirimit kanë qenë të thella, të shpejta e të vrullshme. Kjo përbënte një provë të forcës udhëheqëse të Partisë Komuniste e të vitalitetit të diktaturës së proletariatit. Arsyeja tjetër ishte baza e gjerë shoqërore e revolucionit socialist. Veprimtaria e Partisë dhe e pushtetit për shndërrimin revolucionar të vendit kishte mbështetjen jo vetëm të klasës punëtore e të fshatarësisë së varfër, por edhe të fshatarësisë së mesme e të borgjezisë së vogël të qytetit.

Disfata rrënjësore ushtarake e politike që pësuan çifligarët dhe borgjezia reaksionare më 1944 dhe bazat e shëndosha që kishte pushteti popullor në masat e gjera nuk lejuan që klasat shfrytëzuese të përmbysura ta çonin luftën e tyre klasore pas Çlirimit deri në luftë civile, me gjithë përpjekjet e shumta, sidomos të imperializmit amerikan dhe anglez. Pas Çlirimit këto klasa pësuan disfatën tjetër të madhe në lëmin politik dhe ekonomiko-shoqëror.

## 5. SHKATËRRIMI I NDËRHYRJES ARMIQËSORE TË REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË. DEMASKIMI I VEPRIMTARISË ANTIPARTI TË GRUPIT TË KOÇI XOXES

Sukseset e arritura në vitet e para pas Çlirimit do të ishin edhe më të mëdha, po të mos kishte qenë ndërhyrja e hapët e udhëheqjes së PKJ në punët e brendshme të PKSH dhe të shtetit shqiptar. Me veprimet e saj armiqësore ajo i shkaktoi një dëm të madh ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Duke u mbështetur në politikën konsekuente internacionaliste të PKSH, që synonte forcimin e marrëdhënieve vëllazërore me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, Qeveria e RP të Shqipërisë në korrik të vitit 1946 përfundoi me qeverinë jugosllave Traktatin e Miqësisë, të Bashkëpunimit e të Ndhmës Reciproke midis RP të Shqipërisë dhe RFP të Jugosllavisë. Disa muaj më vonë u nënshkrua edhe Konventa Ekonomike.

PKSH e shikonte me besim aleancën ndërmjet popullit shqiptar dhe popujve jugosllavë që kishin luftuar krah për krah kundër të njëjtit armik për të njëjtat qëllime. Bashkëpunimin e ngushtë e ndihmën reciproke ndërmjet RPSH dhe RFPJ Partia e quante si një faktor të jashtëm të rëndësishëm për ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe për ruajtjen e pavarësisë kombëtare të vendit.

Megjithatë, Sekretari i Përgjithshëm dhe shokë të tjerë të Komitetit Qendror i shikonin me shqetësim ndërhyrjet e përfaqësuesve jugosllavë në punët e brendshme të Partisë e të shtetit shqiptar. Por ende nuk dyshonin se këto ndërhyrje bëheshin me udhëzim e miratim të Komitetit Qendror të PKJ. Duke kundërshtuar të gjitha rastet kur diplomatët dhe ushtarakët jugosllavë në Shqipëri përziheshin në çështjet e brendshme shtetërore e të Partisë, ata përpiqeshin që të zhdukej çdo keqkuptim e çdo pengesë në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe dy partive.

Mirëpo këto përpjekje ndeshën në qëndrimin antimarksisht, antishqiptar të udhëheqjes jugosllave. Në këtë qëndrim, të cilin propaganda jugosllave mendohej ta paraqiste si një politikë «ndihme vëllazërore pa interes», fshihej qëllimi për ta zhdukur pavarësinë e PKSH dhe të shtetit shqiptar.

### **Qëndresa e PKSH kundër ndërhyrjes jugosllave**

Në fillim të vitit 1947 u vunë në jetë marrëveshjet e përfunduara në bazë të Konventës Ekonomike. Masa e parë, që parashikonin këto marrëveshje, ishte barazimi i monedhës. Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria shqiptare, me iniciativën e shokut Enver Hoxha, qysh në fillim e kundërshtuan në parim këtë masë, sepse kishte shumë pengesa që nuk lejonin të arrihej në një barazim real. Shkalla e zhvillimit ekonomik midis dy vendeve, pagat e punonjësve dhe çmimet e mallrave nuk ishin



të barabarta. Por këtë kundërshtim udhëheqja e PKJ e quajti pa vend dhe e cilësoi si shprehje mosbesimi ndaj frymës së Konventës. Pas presionit të ushtruar prej saj, barazimi i lekut me dinarin u bë mbi baza krejt arbitrare në dobi të dinarit.

Masa e dytë që u zbatua ishte njësimi i çmimeve. Edhe për këtë masë Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria shqiptare paraqitën kundërshtime që mbështeteshin në faktin se në industrinë, në bujqësinë e në degët e tjera të prodhimit material të të dy vendeve kishte struktura të ndryshme të fondeve themelore. Rendimenti i punës dhe shpenzimet për njësi produkti ishin gjithashtu të ndryshme. Këta faktorë udhëheqja e PKJ i quajti të parëndësishëm. Si rrjedhim i presionit të ushtruar prej saj, u arrit që për mallrat e të dy vendeve të caktoheshin norma të njëllajta akumulimi dhe që ato të shkëmbeheshin me çmimet e brendshme dhe jo me çmimet e tregut ndërkombëtar.

Masa e tretë ishte bashkimi i doganave. PKSH bëri përpjekje që ky bashkim të shërbente për të lehtësuar shkëmbimin midis dy vendeve. Ndërkohë, udhëheqja e PKJ e shtrembëroi përmbajtjen e marrëveshjes dhe, pas presionesh, arriti të siguronte që çdo ndërmarrje ose tregëtar privat jugosllav të kishte të drejtë të blinte pa asnjë kufizim mallra në tregun shqiptar e dinari të shkëmbehej lirisht me lekun shqiptar. Si pasojë, ndërmarrjet dhe tregtarët privatë jugosllavë morën çdo gjë që gjetën në tregun shqiptar. Boshatisja e tregut krijoi një gjendje shumë të vështirë për ekonominë dhe punonjësit e Shqipërisë. Kjo u bë shkak që vendin ta kërcënonte një inflacion i ri dhe solli një ngritje të përgjithshme të çmimeve në tregun e lirë.

Për bashkërendimin e planeve ekonomike dhe zbatimin e marrëveshjeve të tjera ekonomike u krijua një komision i posaçëm. Udhëheqja jugosllave kërkonte që ky komision të kishte të drejta dhe funksione të atilla, të cilat në fakt do ta shndërronin atë në një qeveri mbi qeverinë shqiptare. Këto kërkesa u hodhën poshtë nga ana e Komitetit Qendror të PKSH.

Në kuadrin e marrëveshjeve ekonomike u krijuan shoqëri të përbashkëta shqiptaro-jugosllave. Ato përfshinë degët më të rëndësishme të ekonomisë popullore. Shoqëritë u ngritën goja në baza barazie. Mirëpo, ndërsa, pala shqiptare, derdhi në shoqëritë e përbashkëta gjithë shumën që i takonte, pala jugosllave nuk investoi asnjë grosh për fondet themelore. Si rrjedhim,

shoqëritë mbaheshin vetëm me fondet themelore të shtetit shqiptar, kurse pala jugosllave përvetësonte gjysmën e fitimit.

Të gjitha këto marrëveshje shkelnin edhe normat më elementare të marrëdhënieve midis dy shteteve sovrane dhe i shkaktuan dëme të rënda ekonomisë së RPSH.

Për zbatimin e marrëveshjeve ekonomike qeveria jugosllave kishte premtuar se për vitin 1947 do t'i jepte Shqipërisë një kredi prej 2 miliardë lekësh. Kredia u plotësua më pak se 50 për qind. Edhe ato mallra të dhëna me kredi nga Jugosllavia ishin llogaritur me çmime dy deri katërfish më të larta nga çmimet ndërkombëtare. E gjithë e ashtuquajtura ndihmë jugosllave përmbli dhej në katër fabrika të vogla, krejt të vjetëruara e të amortizuara prej kohësh. Veç kësaj, kredia u përdor si mjet për të bërë presion mbi Partinë e shtetin shqiptar dhe për të ngjallur mosbesim se ishin gjoja të paaftë për të drejtuar zhvillimin me plan të ekonomisë. Kjo e vështirësoi shumë plotësimin e planit për vitin 1947, i cili qe hartuar duke u mbështetur edhe në ndihmën jugosllave. Qeveria jugosllave nuk i dha RP të Shqipërisë as kredinë e premtuar për vitin 1948.

Për të përballuar nevojat e planit, qeveria u shtrëngua të hidhte në shfrytëzim të gjitha rezervat që kishte në lëndë të parë, materiale ndërtimi e mallra të përdorimit të gjerë. Meqenëse këto ishin të pakta, gjendja ekonomike e financiare e vendit u keqësua.

Krahas me përpjekjet për të zënë pozita të rëndësishme në lëmin ekonomik, udhëheqja e PKJ filloi ndërhyrjet për të shtënë në dorë ushtrinë shqiptare. Duke pasur këtu mbështetje në Drejtorinë Politike, ajo i përqendroi sulmet kundër Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë dhe shefit të tij, shokut Mehmet Shehu, që mbronin vijën e drejtë të Partisë në sektorin ushtarak dhe pavarësinë e Ushtrisë Popullore. Edhe në çështjet ushtarake pikëpamjet e kërkesat e udhëheqjes së PKJ hasën në kundërshtimet e pjesës së shëndoshë të KQ të Partisë, të udhëhequr nga shoku Enver Hoxha.

Për të thyer qëndresën e KQ të PKS, udhëheqja e PKJ i drejtoi atij në qershor 1947 një letër provokuese. Në këtë letër Titoja, Sekretar i Përgjithshëm i PKJ, godiste haptazi Komitetin Qendror të PKS duke e paditur se po shtrembëronte vijën e Partisë dhe se gjoja në Shqipëri «po kristalizohej një vijë e dytë me frymë antijugosllave». Me anën e kësaj aku-

ze udhëheqja jugosllave synonte të forconte pozitën e saj të dobësuarë në PKSH dhe t'i jepte agjentit të vet, Koçi Xoxës, një armë për të luftuar Sekretarin e Përgjithshëm e shokët e tjerë të shëndoshë të udhëheqjes, të cilët tërthorazi i paraqiste si shkaktarë kryesorë të shtrembërimit të vijës së Partisë.

Letra e KQ të PKJ u shtrua për shqyrtim në Byronë Politike. Koçi Xoxja e Pandi Kristoja nuk e kundërshtuan akuzën e udhëheqjes jugosllave, por as guxuan të dilnin hapur në mbrojtje të saj. Byroja e hodhi poshtë atë. Ajo ngarkoi shokun Enver Hoxha t'i përgjigjej Komitetit Qendror të PKJ, duke e cilësuar akuzën e tij krejt të pathemeltë dhe si ndërhyrje të hapët në punët e brendshme të PKSH.

Pas kësaj punë të acaruan edhe më shumë. Udhëheqja e PKJ i shtoi ndërhyrjet dhe presionet kundër PKSH. Për këtë ajo krijoi shkase të reja.

Në fillim të vitit 1947 KQ i PKSH u dha direktivë organeve shtetërore që të fillohej nga puna për hartimin e një plani dyvjeçar (1948-1949) të zhvillimit të ekonomisë. Partia nisej nga gjendja e vërtetë e gjërave në Shqipëri: nga mundësitë e brendshme, nga shkalla e studimeve që ishin bërë dhe nga përvoja që kishin mundur të fitonin organet shtetërore për hartimin e një plani me afat jo shumë të gjatë.

Pa marrë parasysh aspak këtë gjendje, udhëheqja e PKJ kërkoi me këmbëngulje që edhe Shqipëria të hartonte një plan perspektiv pesëvjeçar, ashtu sikurse po bënte edhe Jugosllavia. Jo vetëm kaq, por ajo i rekomandoi qeverisë së RPSH edhe orientimin për këtë plan duke e parë Shqipërinë si një republikë jugosllave. Sipas këtij orientimi ekonomia e RPSH nuk duhej të zhvillohej në mënyrë të pavarur, por të shkrihej në ekonominë e Jugosllavisë. Shqipëria nuk duhej të krijonte e të zhvillonte industrinë e vet kombëtare, por të mjaftohej vetëm me prodhimin e lëndëve të para bujqësore e minerare, të cilat do të përpunoheshin në Jugosllavi. Në shkëmbim të tyre Shqipëria do të merrte nga Jugosllavia mallrat e nevojshme industriale. Ky orientim synonte nënshtrimin dhe shfrytëzimin e ekonomisë shqiptare dhe shndërrimin e saj në një shtojcë të ekonomisë jugosllave.

Komiteti Qendror i PKSH e hodhi poshtë menjëherë këtë orientim. Ai pranoi që të hartohej një plan pesëvjeçar, por e porositi qeverinë që plani të synonte krijimin dhe zhvillimin e industrisë kombëtare, elektrifikimin e vendit, zhvillimin e

bujqësisë mbi baza socialiste dhe që ky plan të mbështetej kryesisht në forcat e brendshme si dhe në ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore.

Për forcimin e zgjerimin e marrëdhënieve politike dhe ekonomike të RP të Shqipërisë me BRSS e vendet e demokracisë popullore, Partia bëri përcapje konkrete. Por këto përcapje hasën në kundërshtimin e udhëheqjes së PKJ, e cila synonte ta mbante Shqipërinë të veçuar nga Bashkimi Sovjetik e nga vendet e demokracisë popullore.

Në korrik 1947 një delegacion qeveritar shkoi në Moskë për bisedime me qeverinë sovjetike. Delegacioni kryesohej nga shoku Enver Hoxha. Në përfundim të bisedimeve Bashkimi Sovjetik i dha RP të Shqipërisë një kredi për pajisjen e bujqësisë me traktorë e makina të tjera bujqësore si edhe për ndërtimin e disa veprave të rëndësishme industriale.

Udhëheqja jugosllave, duke paraqitur si shkas se midis dy vendeve kishte një Traktat të Miqësisë, të Bashkëpunimit e të Ndhmës Reciproke, u përpoq ta pengonte përfundimin e marrëveshjes me BRSS. Ajo shkoi aq larg, sa përfaqësuesi i Jugosllavisë në Moskë i kërkoi përfaqësisë shqiptare t'i dorëzoheshin kopjet e kësaj marrëveshjeje, duke u shprehur në mënyrë kërcënuese se asgjë nuk duhej përfunduar pa pëlqimin e qeverisë jugosllave. Qeveria shqiptare protestoi kundër kësaj ndërhyrjeje të re në punët e brendshme.

Orientimin e drejtë që KQ i Partisë i dha Qeverisë për hartimin e planit dhe vajtjen e delegacionit qeveritar në Moskë, Titoja i përdori si shkas për të formuluar akuzën e dytë kundër PKSH. Në nëntor 1947 ai e paditi qeverinë shqiptare se kishte hartuar një plan pesëvjeçar autarkik dhe joreal, që e shkëpuste ekonominë e Shqipërisë nga ekonomia e Jugosllavisë. Ai dënoi tërthorazi marrjen e ndihmës materiale e morale drejtpërdrejt nga BRSS dhe paditi haptazi shokun Enver Hoxha se, pas kthimit të tij nga Moska, e kishte ndryshuar politikën kundrejt Jugosllavisë. Orientimin ndaj Bashkimit Sovjetik e quajti orientim antijugosllav. Partia Komuniste e Shqipërisë ngarkohej me faj se gjoja kishte lejuar krijimin në Shqipëri të një fronti antijugosllav; se ajo qe shkaktare që marrëdhëniet në mes të popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë ishin përtokë. Më në fund shoku Nako Spiru u padit veçanërisht si bashkëpunëtor me armikun!

Akuzat e reja ishin një goditje tjetër shumë e rëndë kundër PKSH. Ato e tronditën thellë udhëheqjen e Partisë dhe e acaruan në kulm gjendjen e nderë që ishte krijuar në Byronë Politike. Këto akuza i jepnin në dorë fraksionit të Koçi Xoxes minën për të hedhur në erë themelet e Partisë. Dhe në të vërtetë Koçi Xoxja, Pandi Kristoja e Kristo Themelkoja<sup>1</sup> u bënë mbrojtësit më të zjarrtë të tezave jugosllave. Në mbledhjen e Byrosë, që mori në shqyrtim këto akuza, Koçi Xoxja nuk thirri disa nga anëtarët e saj, me qëllim që t'i hiqte shokut Enver Hoxha çdo përkrahje e mbështetje.

Përveç kësaj, në vend që të zbuloheshin shkaqet e ndërhyrjes së udhëheqjes jugosllave dhe të hidheshin poshtë akuzat e saj të trilluara, Koçi Xoxja e Pandi Kristoja i përkrahën ato dhe e vunë tërë theksin mbi «tradhtinë» e Nako Spirut. Kjo ishte një manovër që synonte të fshihte goditjen e rëndë që i bëhej PK të Shqipërisë e Sekretarit të saj të Përgjithshëm nga ana e udhëheqjes jugosllave, si edhe qëllimin e saj.

Në këtë gjendje të acaruar dhe në rrethana shumë të vështira për të, shoku Nako Spiru nuk mundi të qëndronte ashtu si duhet të qëndrojnë komunistët për të përballuar çdo gjendje, por vrau veten.

Për të forcuar marrëdhëniet me vendet që kishin hyrë në rrugën e socializmit, në dhjetor 1947, një delegacion qeveritar me shokun Enver Hoxha në krye shkoi në Sofje, ku nënshkroi Traktatin e Miqësisë, të Bashkëpunimit dhe të Ndhmës Reciproke në mes RP të Shqipërisë dhe RP të Bullgarisë.

Udhëheqja e PKJ u përpoq ta pengonte lidhjen e këtij Traktati. Me anën e Koçi Xoxes, që ishte anëtar i delegacionit shqiptar, ajo u mundua që Traktati të hartohej në një frymë të tillë që për çdo veprim të përbashkët të Shqipërisë me Bullgarinë të merrej pëlqimi paraprak i Jugosllavisë. Kjo kërkesë këmbëngulëse e Koçi Xoxes u hodh poshtë. Në pamundësi të ndalonte lidhjen e Traktatit dhe të ndryshonte frymën e shëndoshë të tij, udhëheqja jugosllave bëri gjithçka që të zvogëlonte vlerën e Traktatit.

---

<sup>1</sup> Kristo Themelkoja i pranoi gabimet e veta dhe bëri autokritikë përpara Partisë pasi u zbulua plotësisht tradhtia e udhëheqjes së PK të Jugosllavisë në qershor 1948.

Duke u shprehur për forcimin e lidhjeve me partitë komuniste motra mbi bazën e parimeve të internacionalizmit proletar, në tetor 1947, Plenumi i KQ të PKSH pranoi plotësisht Deklaratën e Rezolucionin e Konsultës së Varshavës të disa partive komuniste e punëtore, mbajtur në fund të shtatorit 1947 dhe krijimin e Byrosë Informative, e dalë nga Konsulta. PKSH u tregua e gatshme të shkëmbente përvojën e vet dhe, në rast nevojë, të bashkërendonte veprimet e saj me veprimet e partive komuniste e punëtore motra. Komiteti Qendror do të kërkonte në çastin e duhur që PKSH të bëhej anëtare e Byrosë Informative.

### **Zbulimi i planeve antimarksiste dhe antishqiptare të udhëheqjes jugosllave**

Vetëvrasja e Nako Spirut e dëmtoi rëndë Partinë dhe e acaroi edhe më shumë gjendjen e nderë që ishte krijuar në udhëheqjen e Partisë. Kjo i dha dorë klikës revizioniste jugosllave ta përdorte këtë ndodhi si «një provë të vërtetësisë» së akuzave të saj dhe për të ndërmarrrë një goditje të re kundër vijës së PKSH, unitetit të saj dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

Në këto rrethana, Koçi Xoxe, me ndihmën e drejtpërdrejtë të udhëheqjes së PKJ, me flamurin e «shpëtimtarit» të Partisë, përgatiti Plenumin e 8-të të KQ të PKSH. Si platformë për këtë Plenum shërbyen tezat antimarksiste antishqiptare të KQ të PKJ, të shprehura në formë programi në një fjalim të mbajtur nga Koçi Xoxja në Shkollën e Partisë. Gjatë përgatitjeve për Plenumin Koçi Xoxja i shtoi ndjekjet kundër kuadrove të shëndoshë e të sprovuar të Partisë që mbronin vijën e saj të drejtë dhe shpërtheu një fushatë përçmimi kundër komunistëve intelektualë. Me anën e organeve të Sigurimit të Shtetit që drejtoheshin prej tij ai mbliidhte e trillonte të dhëna kundër kuadrove udhëheqës që ishin të padëshirueshëm për të dhe që duhej të dënoheshin në Plenumin e 8-të.

Pikërisht në këtë kohë, udhëheqja jugosllave nëpërmjet Savo Zllatiçit, përfaqësuesit të saj në Republikën Popullore të Shqipërisë, paraqiti në Komitetin Qendror të PKSH planin e vet të «bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë mbi baza federative». Në federatë do të përfshiheshin edhe «popujt e tjerë të Ballkanit, por veçanërisht Bullgaria». Sipas këtij plani, në

fillim federata do të konkretizohej në «marrëdhëniet ekonomike» duke i «shkrirë ekonomitë kombëtare» dhe duke «hartuar plane të përbashkëta». Gjithashtu do të bëhej «bashkimi i ushtrive në një të vetme». Më vonë do të shikohej «krijimi i një shteti të vetëm» që do të ishte gjoja «vullneti i popujve dhe i partive»<sup>1</sup>. Tezat e këtij plani u vunë nga grupi i Koçi Xoxes në themel të përgatitjeve për Plenumin.

Në Plenumin e 8-të të KQ të PKSH që u mbledh në shkurt 1948 veprimtaria armiqësore e titistëve dhe e agjenturës së tyre, të kryesuar nga Koçi Xoxja, kundër PKSH arriti kulmin.

Koçi Xoxja e Pandi Kristoja në fakt e quajtën shokun Enver Hoxha si fajtor kryesor për rrugën gjoja të gabuar që kishte marrë Partia. Nako Spiru u shpall armik i Partisë e i popullit dhe u cilësua spiun. Shoku Mehmet Shehu, i cili arbitrarisht nuk u lejua të merrte pjesë në Plenum, u padit për veprimtari «armiqësore» antijugosllave dhe u përjashtua nga Komiteti Qendror. Koçi Xoxja trilloi të ashtuquajturin fraksion në kokë të Partisë, i cili vepronte «nën hundën e Sekretarit të Përgjithshëm»! Madje u la të kuptohej se në krye të fraksionit qëndronte vetë shoku Enver Hoxha! Kjo ishte një goditje e rëndë kundër pozitës së tij dhe unitetit të Partisë.

Në Plenum u pranuan forma të tilla lidhjesh ekonomike midis Shqipërisë e Jugosllavisë që çonin në zhdukjen e shtetit shqiptar. U hodh ideja e njësimi të ushtrisë shqiptare me ushtrinë jugosllave. U bënë orvatje të hapta për ta shkëputur Shqipërinë nga Bashkimi Sovjetik dhe u shfaqën prirje antisovjetike.

Plenumi i 8-të i thelloi edhe më shumë gabimet në ndërtimin e jetën e brendshme të Partisë. Metodot organizative të udhëheqjes së Partisë u zëvendësuan edhe më shumë me metoda ushtarako-policore.

Në këtë Plenum qëndresa e KQ të PKSH për të mbrojtur vijën e Partisë u thye përpara presionit të udhëheqjes jugosllave. Plenumi pranoi paditë e Titos, të paraqitura në nëntor 1947. Vija e drejtë politike dhe ekonomike e Partisë u

---

<sup>1</sup> Tezat e Savo Zllatiçit mbi bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, paraqitur Komitetit Qendror të PKSH, 5 dhjetor 1947. Shënime nga biseda. AQP.

shkel rëndë. U vu drejtpërdrejt në rrezik pavarësia dhe sovraniteti kombëtar. Plenumi i 8-të krijoi truallin për zbatimin e planit jugosllav për kolonizimin e Shqipërisë. Ky Plenum është një njollë e zezë në historinë e lavdishme të PKSH.

Pas Plenumit grupi i Koçi Xoxes iu përvesh punës me të gjitha forcat për ta vënë në jetë planin jugosllav. Ai shpejtoi përgatitjet që synonin diskreditimin dhe deri zhdukjen fizike të kuadrove udhëheqës të Partisë e të shtetit që kundërshtonin ndërhyrjen dhe presionet e revizionistëve jugosllavë.

Drejtimi dhe veprimtaria e organizatave të masave morën rrugë të shtrembër. U shfaqën prirje për të shthurur organizatën e rinisë. Bashkimeve profesionale iu hoqën një serë funksionesh; ato u shndërruan në një aparat thjesht burokratik.

Në aparatën shtetëror u futën metoda policore. Organet e Sigurimit të Shtetit u vunë mbi Partinë.

Duke kujtuar se tani e kishin nënshtuar plotësisht PKSH, titistët e bënë më të hapur dhe më brutale ndërhyrjen në punët e brendshme të Partisë e të shtetit shqiptar. Komisioni për bashkërendimin e planeve pothuajse u shndërrua në një qeveri të dytë. Shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave po ktheheshin në ndërmarrje thjesht jugosllave. Një komision i posaçëm kontrolli erdhi nga Jugosllavia me detyrën që të ndihmonte në shkrirjen e ekonomisë shqiptare në ekonominë jugosllave, gjë që do të shërbente si një bazë për bashkimin politik të të dy vendeve. Ndërkaq, grupi i Koçi Xoxes hapi një fushatë të gjerë propagandistike për «bashkimin e vëllazërimin» me Jugosllavinë me qëllim që ky bashkim të paraqitej si një akt i kryer gjoja me vullnetin e popullit shqiptar.

Udhëheqja jugosllave dhe fraksioni i Koçi Xoxes kërkuan me këmbëngulje nga KQ i Partisë dhe qeveria largimin e këshilltarëve ushtarakë sovjetikë. Më në fund ata shtruan në Byronë Politike të KQ të PKSH çështjen e njësimimit të komandës së përgjithshme të ushtrisë shqiptare e jugosllave me Titon në krye dhe kërkuan që ajo të miratonte zbatimin e planit për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Me gjithë gjendjen e rëndë që ishte krijuar në Byro dhe me gjithë presionin e jashtëzakonshëm të titistëve dhe të përkrahësve të tyre, këto kërkesa antimarksiste dhe antishqiptare, pas kundërshtimit parimor e të vendosur të shokut Enver Hoxha, nuk u pranuan.



Udhëheqja jugosllave, duke e ndier se qëllimet e saj mund të zbuloheshin së shpejti dhe duke pasur parasysh qëndresën që bënte PKSH, u mundua t'ua arrinte këtyre qëllimeve me anën e frikësimit. Ajo sajoi si shkas rrezikun që i kanosej Shqipërisë nga një sulm i afërt i Greqisë dhe kërkoi të dërgonte me ngut në Shqipëri disa divizione të ushtrisë jugosllave. Në këtë mënyrë pushtimi ushtarak i Shqipërisë do të bëhej fakt i kryer. Kjo do t'u lejonte titistëve të mposhtnin kundërshtimet që do të haseshin për aneksimin e Shqipërisë. Kjo kërkesë u përkrah nga Koçi Xoxja dhe grupi i tij. Ai e Rankoviçi, një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Titos, kishte përgatitur edhe një projekt për të njoftuar botërisht ardhjen e trupave jugosllave, pasi ato të ishin vendosur në tokën shqiptare, si një akt që kryhej në bazë të Traktatit të Miqësisë, të Bashkëpunimit dhe të Ndihmës Reciproke!

— Por edhe ky plan jugosllav nuk u përmbush. Shoku Enver Hoxha e shtroi këtë çështje në udhëheqjen e Komitetit Qendror. Me propozimin e tij u vendos që të mos pranohej sjellja e divizioneve jugosllave në Shqipëri. Ky vendim historik e shpëtoi vendin nga gjakderdhja që do të shkaktonte hyrja e trupave jugosllave dhe nga një robëri e re.

Për kërkesën e udhëheqjes jugosllave për të dërguar në Shqipëri disa divizione dhe për mospranimin e kësaj kërkesë nga ana e Komitetit Qendror të PKSH, shoku Enver Hoxha njoftoi J. Stalinin, ashtu siç e kishte njoftuar më parë edhe për ndërhyrjet e tjera të rënda të Titos e të funksionarëve të ndryshëm jugosllavë në punët e brendshme të Partisë Komuniste të Shqipërisë e të shtetit shqiptar.

Partia dhe shteti po kalonin çaste jashtëzakonisht të vështira. Pikërisht në këtë kohë PKSH u vu në dijeni të letrave që KQ i PK të BS i kishte dërguar Komitetit Qendror të PKJ.

Në këto letra udhëheqja jugosllave kritikohej rëndë për qëndrimin e saj antisovjetik, për ndjekjen e një vije oportuniste që çonte në rivendosjen e kapitalizmit, për shkelje të normave leniniste në jetën e brendshme të partisë dhe për arragancën e mendjemadhësinë e udhëheqësve të PKJ.

Këto letra patën një rëndësi të madhe për PKSH dhe popullin shqiptar. «Në momentin më të rëndë të konfliktit të egër që ekzistonte në mes të Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare dhe udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, konflikti i shkaktuar nga udhëheqësit antimarksistë

jugosllavë, ndihma e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik... që iu dha Partisë sonë dhe gjithë partive të tjera mostra komuniste ishte shpëtimtare për popullin tonë e Partinë tonë Komuniste<sup>1</sup>.

Në dritën e këtyre letrave për KQ të Partisë u bënë tani plotësisht të qarta karakteri dhe qëllimet e ndërhyrjes jugosllave në Shqipëri.

Një kontribut të rëndësishëm për demaskimin e veprimtarisë revizioniste e shoviniste të udhëheqjes së PKJ dha mbledhja e Byrosë Informative që u mbajt në qershor 1948. Byroja Informative arriti në përfundimin e drejtë se udhëheqja e PKJ ishte larguar nga marksizëm-leninizmi dhe ishte vënë në rrugën e revizionimit të tij, kishte tradhtuar socializmin dhe kishte kaluar në pozitën e nacionalizmit borgjez. Duke u nisur nga kjo gjendje, ajo e dënoi udhëheqjen e PKJ si tradhtarë të çështjes së socializmit dhe të internacionalizmit proletar.

KQ i PKSH e pranoi plotësisht rezolutën e Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave». Me një komunikatë të posaçme ai dënoi rrugën tradhtarë, anti-sovjetike dhe antishqiptare të udhëheqjes së PKJ.

Ky qëndrim i Komitetit Qendror u miratua nga e gjithë Partia. Në mbledhjet e tyre gjithë organizatat e partisë shprehën besimin e patundur ndaj KQ dhe Sekretarit të Përgjithshëm, shokut Enver Hoxha.

### **Plenumi i 11-të i KQ të PKSH. Shkatërrimi i ndërhyrjes jugosllave dhe i veprimtarisë armiqësore të Koçi Xoxes**

Pas zbulimit të qëllimeve armiqësore të revizionistëve jugosllavë, marrëdhëniet ekonomike e politike midis Shqipërisë e

Jugosllavisë duhej të spastroheshin nga çdo frymë e përmbajtje shfrytëzuese e nënshtimi. Për këtë qëllim PKSH kërkoi që, me përjashtim të Traktatit të Miqësisë, të Bashkëpunimit dhe të Ndhmës Reciproke, të gjitha marrëveshjet e tjera të rishikoheshin. Por udhëheqja jugosllave nuk e përfilli këtë kërkesë të drejtë. Atëherë Qeveria shqiptare u shtrëngua të

---

<sup>1</sup> Komunikatë e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare, 29 qershor 1948. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 476.

shfuqizonte marrëveshjet ekonomike të lidhura midis RP të Shqipërisë dhe RFP të Jugosllavisë.

Për të asgjësuar nga rrënjët ndërhyrjen jugosllave dhe shtrembërimet në vijën politike dhe organizative të Partisë, në shtator 1948 u mbajt mbledhja e Plenumit të 11-të të KQ të PKSH. Në këtë Plenum morën pjesë edhe ata anëtarë e kandidatë të tij që qenë përjashtuar pa të drejtë nga Plenumi i 8-të.

Plenumi analizoi gjerësisht vijën politike të Partisë dhe veprimtarinë e saj, zbuloi shkaqet e gabimeve dhe përcaktoi masat për kthesën që diktohej nga rrethanat e reja historike.

Plenumi e vlerësoi të drejtë vijën politike që kishte ndjekur Partia prej themelimit të saj. Shtrembërimet e veçanta që u dukën pas Çlirimit ishin pasojë e ndërhyrjes jugosllave. Kjo ndërhyrje dhe veprimtaria trockiste e Koçi Xoxes bëjnë që vija organizative e Partisë në periudhën e pasluftës të kthehej në një vijë përgjithësisht jo të drejtë.

Vendimet kryesore të Plenumit të 2-të dhe të gjitha vendimet e Plenumit të 8-të u cilësuan antimarksiste, të dëmshme dhe, si të tilla, u dënuan dhe u zhvlerësuan.

Plenumi u ndal me hollësi në marrëdhëniet e Partisë dhe të shtetit shqiptar me partinë dhe shtetin jugosllav. Ai i dënoi ashpër synimet nacionalshoviniste e kolonialiste të revizionistëve jugosllavë kundrejt RP të Shqipërisë. Nga ana tjetër, Komiteti Qendror bëri autokritikë për besimin e tepëruar që kishte pasur ndaj udhëheqjes së PKJ.

Plenumi e quajti të padrejtë mbajtjen në gjendje gjysm-ilegale të Partisë edhe pasi kjo ishte bërë parti drejtuese në pushtet. Si gabim i rëndë u cilësua fakti që programi i Partisë fshihej nën programin e Frontit Demokratik, që anëtarët e partisë ruanin fshehtësinë e qenies së tyre si të tillë dhe që orientimet e PKSH botoheshin si vendime të Frontit. Këto forma të huajtura nga PKJ dobësonin rolin udhëheqës të Partisë në gjithë jetën e vendit dhe çonin drejt zhdukjes së saj.

Mungesa e statutit të partisë, që kishte lejuar të futeshin arbitrarisht në Parti format e metodat antimarksiste të udhëheqjes jugosllave, u quajt e dëmshme dhe prandaj u shtrua nevoja e përgatitjes së këtij dokumenti themeltar.

Plenumi ngarkoi me përgjegjësi të rëndë Koçi Xoxen për përkrahjen pa rezerva që u kishte dhënë titistëve dhe për shtrembërimet në vijën organizative të Partisë. Duke mbajtur njëkohësisht edhe funksionin e sekretarit organizativ të

Partisë edhe atë të ministrit të Punëve të Brendshme, Koçi Xoxja e përdori këtë për ta vënë Partinë nën kontrollin e organeve të Sigurimit të Shtetit, për të zbatuar në Parti metoda të drejtimit policor. Kjo kishte sjellë shkeljen e rëndë të centralizmit demokratik dhe mbytjen e kritikës e të autokritikës parimore. Organet udhëheqëse të Partisë nuk zgjidheshin, por emëroheshin nga lart. Ato nuk jepnin rregullisht llogari para masës së komunistëve. Kontrolli i këtyre mbi organet udhëheqëse mungonte. Në shumë raste të drejtat e anëtarit të partisë merreshin nëpër këmbë. Disiplina ishte më tepër mekanike se sa e vetëdijshme. Kolegjialiteti në udhëheqjen e Partisë qe zëvendësuar me urdhrat dhe udhëzimet individuale.

Të meta dhe gabime serioze kishte në politikën e kuadrit. Këtu sundonte sektarizmi, lokalizmi dhe miqësia personale. Kuadrot nuk vlerësoheshin si thesar i çmueshëm i Partisë. Puna për edukimin dhe aftësimin e tyre ishte lënë pothuajse fare pas dore. Të gjithë kuadrot e vjetër, të aftë e me autoritet ishin grumbulluar në qendër, ndërsa organet lokale të partisë e të pushtetit ishin dobësuar shumë.

Kjo gjendje e rëndë brenda Partisë kishte lënë gjurmë të theksuara edhe në gjithë jetën e vendit. Si ministër i Punëve të Brendshme, Koçi Xoxja kishte lejuar shkelje të rënda të ligjëshmërisë socialiste dhe të të drejtave demokratike të punonjësve. Organet e Punëve të Brendshme, sidomos të Sigurimit të Shtetit, ishin kthyer në organe të gjithfuqishme që nuk i nënshtroheshin asnjë kontrolli. Me veprimet e tyre arbitrare e të dëmshme këto organe po shkëputeshin prej popullit.

Kundrejt borgjezisë së vogël patriotike dhe shtresës së intelektualëve nga ana e organeve të Partisë e të shtetit ishin mbajtur në raste të ndryshme qëndrime politike të gabuara. Kundër tregtarëve të vegjël ishin marrë masa të ashpra ekonomike që çonin në eliminimin e tyre të parakohshëm me rruge administrative. Patriotë nga radhët e shtresave të mesme të qytetit e të fshatit, që kishin luftuar për çlirimin e atdheut nën udhëheqjen e Partisë, ishin shpallur padrejtësisht armiq. Për shkak të veprimitarisë armiqësore të elementëve të veçantë intelektualë ishte goditur në mënyrë arbitrare një rreth i gjerë intelektualësh.

Këto ishin gabime me pasoja shumë të rënda që po krijonin në masat e popullit një ndjenjë pasigurie dhe po dobësonin lidhjet e Partisë me masat dhe me Frontin Demokratik.

Plenumi i 11-të i KQ të PKSH u dha fund të gjitha shtrembërimeve e gabimeve në vijën politike dhe organizative të Partisë.

Ai rehabilitoi shokun Nako Spiru si një militant të Partisë dhe mori masa ndëshkimore ndaj Koçi Xoxes, Pandi Kristos dhe disa pjesëtarëve të tjerë të grupit fraksionist. U vendos që të gjithë ata që qenë ngritur në vende drejtuese në Parti ose në shtet në frymën e Plenumit të 8-të të riktheheshin në vendet që kishin pasur më parë. Kurse të gjithë ata që qenë ndëshkuar padrejtësisht u shkarkuan nga dënimet dhe u rikthyen në vendet e mëparshme. Të përjashtuarit në kundërshtim me rregullat e Partisë u ripranuan në gjirin e saj.

Plenumi i 11-të ripohoi qëndrimin e patundur për të ndjekur edhe në të ardhmen politikën e miqësisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë vëllazëror me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Bolshevike të udhëhequr nga J. Stalini që qëndronin në krye të kampit socialist dhe të gjithë lëvizjes revolucionare punëtore demokratike dhe antiimperialiste në botë. Partisë i shtrohej si detyrë të studionte përvojën e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe ta zbatonte atë në mënyrë krijuese në kushtet e Shqipërisë.

Organizatat e partisë u ngarkuan të zhvillonin një punë të gjerë propagandistike për t'ua bërë të qartë masave punonjëse se armiku kryesor i RPSH dhe i gjithë njerëzimit ishin imperialistët amerikanë dhe anglezë, për t'u shpjeguar tradhtinë e udhëheqjes revizioniste jugosllave me Titon në krye ndaj marksizëm-leninizmit dhe kampit socialist, si edhe vepërimtarinë e saj armiqësore kundër PKSH dhe RP të Shqipërisë.

Plenumi vendosi ribotimin e «Zërit të popullit», organ i KQ të Partisë.

Për normalizimin e jetës së PKSH u vendos legalizimi i menjëhershëm i saj, thirrja e Kongresit të Parë dhe zbatimi i parimeve marksiste-leniniste në çështjet organizative.

Plenumi i 11-të i KQ të PKSH shënoi fillimin e një kthesë të thellë për jetën e Partisë dhe për fatet e vendit. Ai rivendosi unitetin në udhëheqje, rriti pa masë autoritetin e Partisë. Vendimet e Plenumit, që u botuan në shtyp për herë të parë, shkundën dhe i vunë në lëvizje gjithë organizatat e partisë, nxitën iniciativën dhe guximin e komunistëve dhe shtuan besimin në forcat e tyre.

Për të zhdukur ndikimin e revizionistëve jugosllavë në sektorin socialist të ekonomisë, u morën masa të ndryshme. U hartua statuti i ri i kooperativave bujqësore dhe dolën ligje të reja që rregullonin e nxitnin zhvillimin ekonomik të fshatit në rrugën e socializmit. Disa elemente të kooperimit kapitalist, të huajtura nga revizionistët jugosllavë u zhdukën. U hoq ndarja e të ardhurave në kooperativa bujqësore sipas sasisë së tokës, mbeti shpërblimi vetëm në bazë të punës, numri i kafshëve të prodhimit dhe sipërfaqja e kopshtit vetjak të kooperativistëve u kufizua. U shtua kujdesi i shtetit për organizimin dhe mbarëvajtjen e kooperativave.

Në këtë kohë e gjithë vëmendja e Partisë dhe e punonjësve ishte përqendruar në përgatitjet për Kongresin I të PKSH. Puna krijuese e masave mori hov të madh për ta pritur Kongresin me planin ekonomik të plotësuar. Entuziazmi revolucionar që kishte pushtuar gjithë popullin e ndihmoi shumë Partinë të përgatitej në një shkallë të lartë për Kongresin e saj.